

VENDIM
Nr. 764, datë 13.12.2024

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT
TË EVROPËS, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “NGRITJA E LABORATORËVE
INTELIGJENTË (*SMART LABS*) – RRJETI I LABORATORËVE TË TIK-ut PËR
SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR (PROJEKTI I GRANTIT SIPAS
KORNIZËS SË INVESTIMEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR)”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, për financimin e projektit “Ngritja e laboratorëve inteligjentë (*smart labs*) – Rrjeti i laboratorëve të TIK-ut për sistemin arsimor parauniversitar (projekti i grantit, sipas Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor)”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Ngritja e Laboratorëve Inteligjentë (Smart Labs) - Rrjeti i laboratorëve të TIK-ut për sistemin
arsimor parauniversitar
(Projekti i Grantit sipas Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor)

MARRËVESHJE GRANTI

NDËRMJET

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Palët në këtë Marrëveshje Granti (në vijim **"Marrëveshja"**) janë Republika e Shqipërisë (**"Përfituesi"**) dhe **Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës**, një organizatë ndërkombëtare, me selinë e saj në 55 avenue Kléber, 75116 Paris, Francë në vijim **"CEB"**, bashkërisht referuar në vijim si **"Palët"**, secila një **"Palë"**).

DUKE PASUR PARASYSH SE

- (A) Në shkurt 2008, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (**"BERZH"**), Banka Evropiane e Investimeve (**"BEI"**), Komisioni Evropian (**"Komisioni"**) dhe CEB-i, (bashkërisht të referuara në vijim si **"Organizatat Partnere"** dhe secila një **"Organizatë Partnere"**), ranë dakord për krijimin e Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (**"WBIF"**) me qëllim rritjen e harmonizimit dhe bashkëpunimit në investimet për zhvillimin social - ekonomik të Ballkanit Perëndimor. Nisma për krijimin e WBIF-it u mirëprit nga Këshilli i Çështjeve Ekonomike dhe Financiare të Bashkimit Evropian në maj 2008 dhe u miratua më pas nga Këshilli Evropian në qershor 2008.
- (B) Për të arritur objektivat e WBIF-it, Organizatat Partnere ranë dakord të bashkëpunojnë me synimin për të ofruar një paketë të integruar financimi të granteve dhe huave në mbështetje të

infrastrukturës prioritare dhe fushave të tjera të zhvillimit social - ekonomik. Prandaj, një pjesë e burimeve të granteve, të vëna në dispozicion për këtë qëllim nga Organizatat Partnere, si dhe burimet e dhëna si kontribut nga shtetet donatore ("**Donatorët EWBIF**") grumbullohen dhe administrohen në një fond të përbashkët bashkëpunimi – Fondi i Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor ("**EWBJF**"), i cili menaxhohet bashkërisht nga BERZH-i dhe BEI-i. Menaxhimi dhe administrimi i burimeve të EWBIF-së rregullohen nga kushtet e përgjithshme për administrimin e EWBIF-së, të miratuar më 7 nëntor 2006, të ndryshuar më 16 qershor 2016 dhe të ndryshuar më tej më 6 shtator 2023 ("**Kushtet e përgjithshme**") dhe Rregullat e Procedurës së WBIF-it, të përditësuar së fundi më 5 dhjetor 2022. Më tej, marrëveshja anësore (pakti shtesë) e WBIF-it për Kushtet e Përgjithshme të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor ndërmjet Komisionit dhe CEB-it u nënshkrua më [12 gusht 2021¹] ("**marrëveshja anësore (pakti shtesë) e WBIF-it**") për të plotësuar Kushtet e Përgjithshme në kuadrin e marrëveshjeve dypalëshe të zbatimit të specifikuara në Marrëveshjen Kuadër të Partneritetit Financiar ndërmjet CEB-it dhe Komisionit.

- (C) Përfituesi ka kërkuar asistencë financiare në formën e një granti me burimet e siguruara nga EWBIF-ja ("**Granti**"), në shumën deri në dhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë Euro (10,137,811.00 Euro), për financimin e aktiviteteve për një projekt granti ("**Projekti i Grantit**"), siç përshkruhet më tej në Nenin 1 dhe Shtojcën A më poshtë, për të mbështetur zbatimin e huasë të CEB-it "Laboratorët Inteligjentë (Smart Labs) - dixhitalizimi i sistemit arsimor shqiptar" me referencën e identifikimit të projektit të CEB-it: LD 2175 ("**Projekti i Huasë**"). CEB-i dhe Përfituesi do të lidhin një marrëveshje kuadër huaje në lidhje me Projektin e Huasë ("**Marrëveshja Kuadër e Huasë**") në ose rreth datës së kësaj Marrëveshjeje.
 - (D) Formulari i Aplikimit për Grantin ("**FAG**") për zbatimin e Projektit të Grantit të mësipërm u dorëzua në Asamblenë e Kontributeve të WBIF-it nga Përfituesi, duke vepruar nga dhe nëpërmjet Koordinatorit Kombëtar të Instrumentit të Asistencës të Parazgjerimit ("**KKIPA/NIPAC**").
 - (E) Më 13 janar 2023, Asambleja e Kontribuuesve të WBIF-it miratoi ndarjen e fondeve për Projektin e Grantit dhe është rënë dakord që të financohet ky Projekt Granti për të mbështetur Projektin e mësipërm të Huasë nga buxheti përkatës i alokuar nga EWBIF-ja. Asambleja caktoi CEB-in si institucionin kryesor financiar ("**Institucioni Kryesor financiar**").
 - (F) Me burimet e siguruara nga EWBIF-ja, CEB-i dëshiron t'i japë një grant Përfituesit bazuar në termat dhe kushtet e specifikuara në këtë Marrëveshje.
 - (G) Duke pasur parasysh Politikën e Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale të CEB-it, të miratuar nga Rezoluta 1588 (2016) e Këshillit Administrativ të CEB-it (në vijim "**Politika e Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale**").
 - (H) Duke pasur parasysh Udhëzimet e Prokurimit të CEB-it, të miratuara nga Rezoluta 1655 (2023) e Këshillit Administrativ të CEB-it (në vijim "**Udhëzimet e Prokurimit**").
 - (I) Duke pasur parasysh Politikën e Informacionit Publik të CEB-it, të miratuar nga Këshilli Administrativ i CEB-it në korrik 2020 (në vijim "**Politika e Informacionit Publik**").
-

- (J) Duke pasur parasysh Rregulloren e CEB-it për Mbrojtjen e të Dhënave, të miratuar nga Rezoluta 1639 (2022) e Këshillit Administrativ të CEB-it (në vijim, "**Rregullorja për Mbrojtjen e të Dhënave**").
- (K) Duke pasur parasysh Kartën Kundër Korrupsionit të CEB-it, të miratuar nga Rezoluta 1628 (2021) e Këshillit Administrativ të CEB-it në mars 2021 (në vijim, "**Karta Kundër Korrupsionit**").
- (L) Duke pasur parasysh politikën e CEB-it për juridiksionet jo në përputhje/jo bashkëpunuese, të miratuar nga Rezoluta 1630 (2021) e Këshillit Administrativ të CEB-it në shtator 2021 (në vijim, "**Politika për juridiksionet jo në përputhje / jo bashkëpunuese**").
- (M) Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet CEB-it dhe Përfituesit është përcaktimi i termave dhe kushteve në lidhje me (i) transferimin dhe përdorimin e Grantit, (ii) zbatimin e Projektit të Grantit (në mbështetje të zbatimit të Projektit të Huasë) dhe (iii) raportimin dhe auditimin mbi përdorimin e Grantit.

TASHMË DHE SI RRJEDHOJË Palët bien dakord si më poshtë:

A. Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje termat dhe shprehjet e mëposhtme do të kenë kuptimin e mëposhtëm, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

"AKSHI" do të thotë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia Kombëtare e Përfituesit për Shoqërinë e Informacionit.

"Kostot e mbylljes" do të thotë kostot që lidhen me Raportin e Përfundimit, vlerësimin përfundimtar, auditimin dhe kostot e tjera të lidhura me mbylljen e Projektit të Grantit, të cilat mund të shkaktohen pas Periudhës së Zbatimit, por përpara afatit përfundimtar për Raportin e Përfundimit të specifikuar në Nenin 7.1.

"Datë Përfundimi" do të thotë data e përcaktuar në Nenin 2.1.6 në të cilën përfundon Periudha e Zbatimit të Projektit të Grantit dhe mbi të cilën nuk mund të shkaktohen kosto të mëtejshme (përveç Kostove të Mbylljes).

"Raport Përfundimi" ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7.1(a)(ii) në vijim.

"Kontraktor" i referohet çdo pale të tretë me të cilin Përfituesi lidh një kontratë për punime, furnizime dhe/ose shërbime që do të financohen me Grantin për zbatimin e Projektit të Grantit.

"Kosto (t) e Shkaktuar (a)" do të thotë (i) kostot për aktivitetet e zbatuara (shërbimet e dhëna, furnizimet e ofruara dhe punimet e kryera) në bazë të Projektit të Grantit përpara datës së Përfundimit dhe (ii) Kostot e Mbylljes, dhe të cilat pranohen nga CEB-i si kosto të pranueshme sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. Për shmangien e dyshimit, paradhëniet/financimi paraprak nuk do të konsiderohen si kosto të shkaktuara.

“Kërkesë për Disbursim” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 1.2.3 në vijim.

“Sistem i Zbulimit dhe Përfundimit të Hershëm” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5.1.3(b) në vijim.

“Kosto të Pranueshme” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 2.1.2 në vijim.

“Data e Përfundimit” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 2.1.7(b) në vijim.

“Euro” ose shenja **“EUR”** do të thotë valuta e ligjshme e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (BE), të cilat herë pas here e miratojnë atë si valutën e tyre në përputhje me dispozitat përkatëse të Traktatit të BE-së dhe Traktatit mbi Funksionimi i BE-së ose traktatet e tyre pasuese.

“Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut” do të thotë Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e datës 4 nëntor 1950, CETS nr.5, e ndryshuar herë pas here.

“Karta Sociale Evropiane” do të thotë Karta Sociale Evropiane e datës 3 maj 1996, CETS nr.163, e ndryshuar herë pas here.

“Donatorët EWBJF” ka kuptimin që i është dhënë në Pikën (B) më sipër.

“Kostot e parashikuara” do të thotë kostot e pranueshme të planifikuara të shkarkohen në kuadër të Projektit të Grantit gjatë periudhës prej një (1) viti.

“Grant” ka kuptimin që i është dhënë në Pikën (E) më sipër.

“Projekt i Grantit” ka kuptimin që i është dhënë në Pikën (E) më sipër.

“TIK” do të thotë teknologjia e informacionit dhe komunikimit.

“Periudhë Zbatimi” do të thotë periudha nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje deri në Datën e Përfundimit.

“Projekt i Huasë” ka kuptimin që i është dhënë në Pikën (E) më sipër.

“Progres Raporti” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 7.1 në vijim.

“Praktikat e Ndaluar” ka kuptimin që i është dhënë në Nenin 5.1.1 në vijim.

“MAS” ka kuptimin Ministria e Arsimit dhe Sportit të Përfuturit.

“Listë e Sankcioneve” do të thotë (i) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargo armësh të lëshuar nga BE-ja në përputhje me Kapitullin 2 të Titullit V të Traktatit për Bashkimin Evropian, si dhe Nenin 215 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, të mundësuar në faqen

zyrtare të internetit të BE-së www.sanctionsmap.eu² ose ndonjë faqe pasuese, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here; ose (ii) çdo masë kufizuese ekonomike, financiare dhe tregtare dhe embargo armësh, të lëshuar nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara në përputhje me Nenin 41 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të mundësuar në faqen zyrtare të internetit të Kombeve të Bashkuara ose në çdo faqe pasuese, të ndryshuar dhe të plotësuar herë pas here.

“Person i Sanksionuar” do të thotë çdo individ ose subjekt i listuar në dhe/ose ndryshe që i nënshtrohet një ose më shumë Listave të Sanksioneve.

“Laborator Inteligent (Smart Lab)” do të thotë një dhomë ose ambient i dedikuar brenda ambienteve të një shkolle që përfshin pajisje TIK-u, infrastrukturë dhe orëndi TIK-u, që mund të përdoret për një gamë të gjerë qëllimesh arsimore dhe siç specifikohet më tej në Shtojcën 1.

“Llogari e Posaçme” i referohet llogarisë (ve) në Euro të mbajtur/a nga Përfituesi në një bankë të caktuar, siç përshkruhet më tej në Nenin 1.2.7 më poshtë, për marrjen dhe menaxhimin e fondeve të disbursuara nga CEB-i për qëllimin e Projektit të Grantit.

“Menaxhim i Qëndrueshëm Financiar” i referohet parimit mbi zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, përkatësisht ekonomisë, efektshmërisë dhe efikasitetit (duke përfshirë në lidhje me kontrollin e brendshëm). Parimi i ekonomisë kërkon që burimet e përdorura në ndjekjen e zbatimit të Projektit të Grantit të vihen në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe me çmimin më të mirë. Parimi i efektshmërisë lidhet me arritjen e objektivave specifike dhe rezultateve të synuara. Parimi i efikasitetit lidhet me marrëdhënien më të mirë midis burimeve të përdorura dhe rezultateve të arritura.

“Transh” do të thotë një shumë e disbursuar ose që do të disbursohet nga CEB-i me anë të Grantit.

B. Interpretimi

Përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, referenca për:

- (a) këtë Marrëveshje do të interpretohet si referenca ndaj kësaj Marrëveshjeje të plotësuar, ndryshuar ose ripërcaktuar herë pas here;
- (b) kjo Marrëveshje përbëhet nga pjesët e mëposhtme:
 - (i) Nenet në pjesën kryesore të kësaj Marrëveshjeje;
 - (ii) Shtojca A: Përshkrimi i Projektit të Grantit;
 - (iii) Shtojca B: Kërkesa për Disbursimin e Transhit të Grantit (Modeli);
 - (iv) Shtojca C: Progres Raporti / Raporti i Përfundimit (Model);
 - (v) Shtojca D: Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit;
 - (vi) Shtojca E: Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve;
- (c) shtojcat, siç janë renditur këtu më sipër, përbëjnë pjesë integrale të Marrëveshjes. Në rast mospajtimesh, mospërputhjesh dhe/ose konflikteve midis kushteve të dispozitave të ndonjë

²Harta e Sanksioneve të BE-së është një mjet TI për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Kini parasysh se Gazeta Zyrtare e BE-së është burimi zyrtar i ligjit të BE-së dhe në rast mosmarrëveshjes, përmbajtja e tij ka përparësi mbi atë të faqeve përkatëse të internetit.

pjesë që përbën këtë Marrëveshje, pjesët e Marrëveshjes do të kenë renditjen e mëposhtme sipas përparësisë:

- (i) Nenet në pjesën kryesore të kësaj Marrëveshjeje;
 - (ii) Shtojca E: Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve;
 - (iii) Shtojca A: Përshkrimi i Projektit të Grantit;
 - (iv) Shtojca B: Kërkesa për Disbursimin e Transhit të Grantit;
 - (v) Shtojca C: Raporti i Progresit/Raporti i Përfundimit; dhe
 - (vi) Shtojca D: Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit;
- (d) në rast mospajtimi ose mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë plani, specifikimi, skeduli investimi, buxheti, rregulloreje ose dokumenti tjetër përkatës të Projektit të Grantit të miratuar nga CEB-i, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi mbi ato dokumente.
- (e) referencat në këtë Marrëveshje për Nenet, Pikat dhe Shtojcat janë referenca përkatësisht ndaj neneve, pikave dhe shtojcave të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse përcaktohet ndryshe; dhe
- (f) fjalët që tregojnë njëjtesin përfshijnë shumësin dhe anasjelltas.

C. Titujt

Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë asnjë domethënie juridike dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

D. Rrumbullakimi

Për qëllimet e ndonjë llogaritjeje të përmendur në këtë Marrëveshje, të gjitha shumat e valutës të përdorura ose që rezultojnë nga llogaritjet e mësipërme do të rrumbullakosen, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në përkufizimin përkatës të valutës, në dy shifrat dhjetore më të afërta në valutën përkatëse (me 0,005 duke u rrumbullakosur lart (*p.sh.*, .674 duke u rrumbullakosur poshtë në .67 dhe .675 duke u rrumbullakosur lart në .68).

Neni 1 Granti

Shuma.

- 1.1.1. Në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara si më poshtë në këtë Marrëveshje, CEB-i është i gatshëm t'i vërë në dispozicion Përfituesit, dhe Përfituesi pranon në këtë mënyrë Grantin në një shumë totale deri në **dhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë Euro (10,137,811.00 EURO)** për zbatimin e Projektit të Grantit.
- 1.1.2. Pranohet dhe bihet dakord shprehimisht se CEB-i nuk do të jetë i detyruar të kryejë asnjë pagesë në bazë/ose në përputhje me këtë Marrëveshje përtej dhe mbi shumën e vënë në dispozicion në bazë të Grantit, përveç në masën që një shumë në lidhje me dhe e barabartë me një pagesë të tillë, është e disponueshme për qëllimet e Projektit të Grantit në llogarinë fiduciare të EWBIF-it të mbajtur nga CEB-i për të marrë Grantin ("**Llogaria e CEB-it**"). CEB-i nuk do të ketë asnjë

përgjegjësi ndaj Përfituesit ose palëve të treta në lidhje me shpenzimet ose detyrimet e shkaktuara në lidhje me këtë Marrëveshje që tejkalojnë shumën e vënë në dispozicion CEB-it ose në bazë të Grantit për qëllimin e Projektit të Grantit.

1.2. Procedurat e pagesës.

1.2.1. CEB-i do t'i disbursojë grantin Përfituesit në të paktën dy Transhe. Shuma e secilit Transh do të përcaktohet nga CEB-i në përputhje me kostot e shkaktuara dhe/ose kostot e parashikuara. Disbursimi i parë do të bëhet brenda dymbëdhjetë (12) muajve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Granti, dhe disbursimi i fundit jo më vonë se 31 dhjetor 2028, përveç nëse miratohet ndryshe nga CEB-i.

1.2.2. Shuma e Transhit të parë nuk do të kalojë tridhjetë për qind (30%) të Grantit si paradhënie, përveç kur bihet dakord ndryshe nga CEB-i bazuar në një kërkesë të justifikuar siç duhet nga Përfituesi.

Lëshimi i Transhit të parë është sipas kushteve të përshkruara në Nenet 1.1.2 dhe 1.4.1 (*Kushtet e Pagesës*).

1.2.3. Për çdo lëshim të Transhit, Përfituesi do t'i paraqesë CEB-it një kërkesë disbursimi në formën e një letre, kryesisht në formën e përcaktuar në Shtojcën B të kësaj Marrëveshjeje (një "**Kërkesë Disbursimi**"), së bashku me çdo dëshmi të kërkuar në përputhje me Nenin 1.4 (*Kushtet e Pagesës*).

1.2.4. Lëshimi i Transheve pasuese i nënshtrohet kushteve të specifikuara në Nenin 1.1.2 dhe Nenin 1.4.2 (*Kushtet e Pagesës*).

1.2.5. Përfituesi pranon se pagesa që i bëhet Përfituesit pas një kërkesë të tillë do të përbëjë disbursim në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

1.2.6. Përfituesi është përgjegjës për aplikimin e fondeve të disbursuara në bazë të kushteve të kësaj Marrëveshjeje për zbatimin e Projektit të Grantit.

1.2.7. CEB-i do të depozitojë çdo Transh sipas detajeve të Llogarisë së Posaçme të mëposhtme:

Emri i përfituesit: Ministria e Financave

Adresa e përfituesit: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri

Numri i llogarisë IBAN: AL89 1011 1008 0000
0000 2111 001E

Kodi Swift: STANALTRXXX

Emri/adresa e Bankës: Banka e Shqipërisë

Çdo ndryshim në detajet e Llogarisë së Posaçme më sipër, do t'i njoftohet menjëherë CEB-it me shkresë të nënshkruar nga një nënshkrues i autorizuar siç duhet i Përfituesit.

1.3. Valuta

Granti do të disbursohet në Euro (EUR). Çdo shumë që Përfituesi i detyrohet CEB-it sipas kësaj Marrëveshjeje, do të paguhet në Euro. Të gjitha llogaritë dhe pasqyrat financiare në lidhje me Llogarinë e Posaçme të Përfituesit do të shprehen në Euro.

1.4. Kushtet e pagesës.

1.4.1. Disbursimi i Transhit të parë nga CEB-i për Përfituesin i nënshtrohet:

- (a) dëshmisë në gjuhën angleze të personit (ve) të autorizuar për të ekzekutuar Marrëveshjen dhe Kërkesave të Disbursimit në emër të Përfituesit së bashku me nënshkrimin (t) model të vërtetuar të këtij personi (ve);
- (b) një konfirmim në gjuhën angleze të lëshuar nga Ministri i Financave (Përfituesi) që konfirmon përfundimin e procedurave të tij të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje për kënaqësinë e CEB-së dhe që Marrëveshja është e vlefshme, detyruese dhe e zbatueshme në përputhje me kushtet e tij në Juridiksionin e përfituesit;
- (c) marrjes së një Kërkese të plotësuar për Disbursim nga Përfituesi;
- (d) marrjes së një raporti financiar me anë të së cilës specifikohet kostoja e Projektit të Huasë dhe kostoja e Projektit të Grantit të llogaritura dhe të përditësuar, kostot e shkaktuara, kostot e parashikuara dhe burimet e financimit. Çdo ndryshim në të gjitha kostot e llogaritura (Projekti i Grantit dhe Projekti i Huasë) i paraqitur në FAG duhet të arsyetohet siç duhet;
- (e) dëshmia për përfundimin e aktiviteteve të projektimit, dhe më konkretisht, projektin e plotë të detajuar, të cilat janë parakusht për shpenzimet e pranueshme sipas Nenit 2.1.1., jepet dhe miratohet nga CEB-i;
- (f) marrjes së një plani prokurimi të pranueshëm për CEB-in.

1.4.2. Disbursimi i Transheve të mëvonshme i nënshtrohet:

- (a) marrjes së një kërkesë të plotësuar për disbursim nga Përfituesi;
- (b) marrjes së konfirmimit se të paktën shtatëdhjetë për qind (70%) e Transhit të menjëhershëm paraardhës dhe njëqind për qind (100%) e të gjitha Transheve të tjera të mëparshme janë alokuar për pagesën e kostove të shkaktuara; dhe
- (c) verifikimit nga CEB-i të raporteve dhe materialeve të tjera të specifikuara në Nenin 7 (*Monitorimi dhe Raportet*) më poshtë të paraqitura nga Përfituesi për CEB-in, në secilin rast që nga disbursimi i Transhit të parë nga CEB-i.

Neni 2

Kushtet për përdorimin e Grantit

2.1. Përdorimi i të ardhurave nga Granti.

2.1.1. Granti i vendos në dispozicion nga CEB-i, do të përdoret ekskluzivisht për të financuar kategoritë e kostos së Projektit të Grantit, siç përshkruhet në Buxhetin Indikativ të Projektit të përfshirë në Shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje dhe për të zbatuar Projektin e Grantit në një mënyrë në përputhje me Shtojcën A dhe FAG-un, përveç nëse bihet dakord ndryshe me shkrim nga CEB-i.

2.1.2. Granti do të financojë vetëm kostot e lidhura me Projektin e Grantit që plotësojnë të gjitha kriteret e përshkruara më poshtë, në mënyrë që të jenë të pranueshëm për financim në bazë të Grantit (në vijim "**Kostot e Pranueshme**"):

- (i) ato janë shkaktuar në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;
- (ii) ato janë të nevojshme për realizimin e Projektit të Grantit që i atribuohet drejtpërdrejt Projektit të Grantit, që lind si pasojë e drejtpërdrejtë e zbatimit të këtyre kontratave dhe të vendosura në raport me përdorimin aktual;
- (iii) ato janë shkaktuar realisht nga Përfituesi, *d.m.th* ato përfaqësojnë shpenzime reale të përballuara përfundimisht dhe realisht prej tij;
- (iv) ato janë të arsyeshme, të justifikuara në përputhje me parimin e Menaxhimit të Qëndrueshëm Financiar dhe në përputhje me praktikën e zakonshme të Përfituesit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit;
- (v) ato janë shkaktuar gjatë periudhës së zbatimit ose janë kosto mbylljeje;
- (vi) ato janë të identifikueshme dhe të mbështetura nga dokumente mbështetëse, veçanërisht të përcaktuara dhe të regjistruara në përputhje me praktikën kontabël të Përfituesit;
- (vii) mbulohen nga Buxheti i Projektit Indikativ i përfshirë në Shtojcën A; dhe
- (viii) janë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe social në fuqi.

2.1.3. Granti nuk do të përdoret për të financuar:

- (a) ndonjë tatim, taksë dhe tarifë, duke përfshirë por pa u kufizuar në tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në masën që janë të rikuperueshme/të zbritshme; të gjitha taksat, tatimet, tarifatat dhe

detyrimet ose përjashtimet e tjera për mallrat, punët dhe shërbimet që do të ndërmerren në kuadër të Projektit të Grantit, do të rregullohen nga legjislacioni i Përfituesit;

- (b) shpërblimet, provizionet, rezervat ose kostot që nuk janë të lidhura me pagesat. Kontributet e punëdhënësve për pensionet ose për çdo fond tjetër sigurimi të punonjësve të drejtuar nga Përfituesi, do të jenë të pranueshme vetëm në masën që nuk kalojnë koston e shkaktuar gjatë periudhës raportuese, të llogaritura sipas standardeve të mëposhtme ndërkombëtare të kontabilitetit në fuqi.;
 - (c) kostot e blerjes së tokës ose ndërtesave;
 - (d) kthimin e kapitalit;
 - (e) borxhet dhe tarifat e shërbimit të borxhit;
 - (f) shpenzimet (duke përfshirë asistencën teknike) e shkaktuara përpara fillimit të Periudhës së Zbatimit;
 - (g) gjokat, penalitetet financiare dhe shpenzimet e procesit gjyqësor;
 - (h) tarifat bankare, shpenzimet financiare, kostot e garancive dhe tarifat e ngjashme;
 - (i) kostot e shkaktuara gjatë dhe që lidhen me pezullimin e zbatimit të Marrëveshjes (përjashtimisht, disa kosto minimale që çmohen të nevojshme për të lejuar rifillimin e aktiviteteve të pezulluara sapo kushtet që e lejojnë, mund të jenë të pranueshme);
 - (j) kostot e deklaruara nga Përfituesi në bazë të një marrëveshjeje tjetër të financuar nga buxheti i Bashkimit Evropian (përfshirë përmes Fondit Evropian të Zhvillimit);
 - (k) në masën që janë llogaritur për kostot totale të Projektit të Grantit, kontributet në natyrë.
- 2.1.4. Çdo interes negativ që mund të shtohet në të ardhurat e Grantit, nuk do të konsiderohet si një kosto e pranueshme dhe çdo interes pozitiv i fituar do të përdoret ekskluzivisht për financimin e Projektit të Grantit.
- 2.1.5. Fondet e vëna në dispozicion Përfituesit do të përdoren në kohë. Në veçanti, faturat për kostot e shkaktuara para Datës së Përfundimit do të paguhën nga Përfituesi jo më vonë se një (1) muaj pas Datës së Përfundimit dhe faturat për Kostot e Mbylljes do të paguhën jo më vonë se në afatin për Raportin e Përfundimit, siç specifikohet në Nenin 7.1.
- 2.1.6. Çdo balancë që nuk është përdorur për të paguar palët e treta për kostot e shkaktuara ose kostot e mbylljes në përputhje me Nenin 2.1.5 më sipër ose çdo pagesë që duhet të kryejë Përfituesi në përputhje me Marrëveshjen, do të depozitohet në EURO në llogarinë e mëposhtme të CEB-it, përveç nëse bihet dakord ndryshe nga Palët, brenda tridhjetë (30) ditëve nga afati i pagesës i përmendur në Nenin 2.1.5 më sipër, ose nëse nuk parashikohet një afat i tillë, brenda tridhjetë (30) ditëve nga Data e Përfundimit ose njoftimit nga CEB-i me anë të së cilës kërkohet shlyerja në përputhje me Nenin 9.2 më poshtë:

Emri i mbajtësit:	Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës
Adresa e mbajtësit:	55, avenue Kléber 75116 Paris, France

Kodi Swift i mbajtësit: CEFPPRPP
Emri i bankës: Deutsche Bank AG Frankfurt
Adresa e Bankës: Taunusanlage 12, 60325 Frankfurt am Main, Germany
Kodi Swift i Bankës: DEUTDE33
IBAN: DE44500700100928738400
Referenca: WB-IG06-SRB-SOC-02 Fondet e papërdorura

Përfituesi do të njoftojë CEB-in me email në adresën projects@coebank.org për sa vijon: (a) shumën e rimbursuar; (b) datën e vlerës së rimbursimit; (c) që rimbursimi është nga Përfituesi në përputhje me këtë Marrëveshje.

2.1.7. Afatet

(a) Data e përfundimit do të jetë siç specifikohet në Shtojcën A.

(b) Data e Përfundimit:

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, **Data e Përfundimit** do të korrespondojë në datën më të hershme të: (1) datës deri në të cilën, në mënyrë kumulative (i) të gjitha pagesat nga Përfituesi ndaj palëve të treta për kostot e shkaktuara ose kostot e mbylljes janë përfunduar dhe (ii) Raporti i Përfundimit është pranuar, nëse është e zbatueshme, si i pranueshëm nga CEB-i dhe (iii) CEB-i ka paguar çdo gjendje të fondeve ose Përfituesi ka kthyer çdo gjendje të fondeve, sipas rastit, ose (2) 30 qershor 2029.].

Nëse ndonjë nga Palët kërkon një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me Nenin 15 (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*), Data e Përfundimit do të shtyhet deri në përfundimin e kësaj procedure dhe në çdo rast deri kur çdo auditim, verifikim, apelim, proces gjyqësor ose ndjekje e kërkesës është disponuar.

(c) Çdo afat i përcaktuar në këtë Marrëveshje mund të zgjatet vetëm kur arsyetohet siç duhet nga Përfituesi dhe me pëlqimin me shkrim të CEB-it.

2.2. Vizibiliteti

2.2.1. Përfituesi (drejtpërdrejt ose nëpërmjet AKSHI ose MAS) do të marrë të gjitha masat e duhura për të pranuar dhe bërë gjithmonë publike se Projekti i Grantit ka marrë financim nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF).

2.2.2. Në mënyrë specifike, Përfituesi, (drejtpërdrejt ose nëpërmjet AKSHI ose MAS) minimalisht do të zbatojë dhe kontribuojë në aktivitetet e përfshira në këtë klauzolë 2.2 dhe Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit të detajuar në Shtojcën D të këtij dokumenti, për të cilën është përgjegjës. Në veçanti, të gjitha pllakat e ndërtimit të përkohshme dhe të përhershme duhet të mbajnë, minimalisht, logot e WBIF-it dhe CEB-it, të cilat do të jenë të barabarta për nga madhësia dhe rëndësia me artikujt e tjerë të identitetit vizual të pranishëm në pllaka të tilla.

2.2.3. Raportet specifike mbi zbatimin e Projektit të Grantit të përgatitura nga Përfituesi (drejtpërdrejt ose nëpërmjet AKSHI ose MAS) ose konsulentët/promovuesit e Projektit të Grantit të financuar nga të ardhurat e Grantit, duhet të kenë njoftimin e mëposhtëm:

“Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, në kuadër të Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor, të marrë nëpërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu janë të (emri i autorit) dhe për këtë arsye në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Kontribuesve në Fondin e Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, BERZH-it, si bashkë-menaxheri i Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, ose Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, si Institucioni Financiar Drejtues në lidhje me projektin.”

- 2.2.4. Progres Raportet vjetore dhe Raporti i Përfundimit të përcaktuar në Nenin 7 të Marrëveshjes, do të përfshijnë masat e marra nga Përfituesi për të garantuar vizibilitetin e CEB-it dhe WBIF-it.

Neni 3

Përgjegjësia për Projektin e Grantit

- 3.1. Projekti i Grantit i financuar nga Granti, siç përshkruhet më tej në Shtojcën A, do të zbatohet nga Përfituesi gjatë Periudhës së Zbatimit dhe në përputhje me Marrëveshjen.
- 3.2. Përfituesi, duke vepruar nëpërmjet [Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit] si organizata zbatuese të Projektit të Grantit, do të ketë përgjegjësinë për Grantin e marrë nga CEB-i dhe zbatimin dhe mbikëqyrjen e Projektit të Grantit.
- 3.3. Përfituesi (drejtpërdrejt ose nëpërmjet AKSHI ose MAS) do ta mbajë CEB-in të informuar për ecurinë e Projektit të Grantit dhe Projektit të Huasë, duke i dhënë CEB-it informacionin dhe raportet e nevojshme në bazë të Neneve 6 dhe 7 të Marrëveshjes.

Neni 4

Sipërmarrjet e veçanta

- 4.1. *Përdorimi i të ardhurave nga granti.* Përfituesi merr përsipër që të përdorë të ardhurat e Grantit vetëm për financimin e Projektit të Grantit, siç përshkruhet më tej në Nenin 2.1 më sipër.
- 4.2. *Kujdesi dhe verifikimi paraprak.* Përfituesi do të përdorë Grantin në përputhje me ecurinë e aktiviteteve në lidhje me Projektin e Grantit dhe do të tregojë të gjithë kujdesin dhe verifikimin paraprak, dhe do të ushtrojë të gjitha mjetet e përdorura zakonisht (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, mjetet ligjore, financiare, menaxhuese dhe teknike) të nevojshme për zbatimin e duhur të Projektit të Grantit.
- 4.3. *Përmbushja.* Përfituesi do të sigurojë që Projekti i Grantit të kryhet dhe të përmbushet brenda Datës së Përfundimit të specifikuar në Shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse CEB-i bie dakord ndryshe me shkrim.
- 4.4. *Kostot e shkaktuara.*
- 4.4.1. Pa cenuar Nenin 1.1.1 më sipër, nëse kostot totale të pranueshme rriten ose rishikohen për çfarëdo arsye, Përfituesi do të sigurojë që burimet financiare shtesë për përfundimin e Projektit të Grantit të jenë të disponueshme pa iu drejtuar CEB-it. Planet për financimin e kostove të

rritura do t'i komunikohen CEB-it pa vonesë. Në çdo rast, CEB-i nuk ndërmerr të mbulojë asnjë shpenzim që tejkalon shumën e Grantit të përcaktuar në Nenin 1.1.1 të Marrëveshjes.

4.4.2. Në çdo rast, pranohet dhe bihet dakord shprehimisht që CEB-i nuk do të jetë i detyruar të kryejë ndonjë pagesë në bazë dhe/ose në përputhje me këtë Marrëveshje, përveç në masën që një shumë në lidhje me dhe të barabartë me këtë pagesë, është e disponueshme nga fondet e Grantit të mbajtura në CEB-i për qëllime të Projektit të Grantit.

4.5. *Detyrimet për Bashkëpunimin.* Përfituesi ndërmerr të sigurojë që punonjësit e tij përkatës dhe konsulenti i jashtëm bashkëpunojnë gjatë gjithë kohës me CEB-in.

4.6. *Prokurimi.*

4.6.1. Prokurimi i furnizimeve dhe/ose shërbimeve sipas Projektit të Grantit duhet të jetë në përputhje me Udhëzimet e Prokurimit të CEB-it.

4.6.2. Përfituesi do të sigurojë që AKSHI dhe MAS do t'i përfshijë praktikatat e qëndrueshme të prokurimit publik në aktivitetet e prokurimit të Projektit të Grantit, veçanërisht në kriteret e dhënies së kontratës dhe kushtet e veçanta të ekzekutimit të kontratave, në masën e lejuar nga ligjet kombëtare të prokurimit.

4.6.3. Përfituesi do të sigurojë që AKSHI dhe MAS do të kryejë të gjitha procedurat e prokurimit në kuadër të Projektit të Grantit në përputhje me ligjet e prokurimit publik të Republikës së Shqipërisë. Në veçanti, Përfituesi do të sigurojë që çdo palë që ka interes në marrjen e një kontrate të caktuar për financim në kuadër të Projektit të Grantit, do të ketë akses në procedurat e shqyrtimit dhe mjetet juridike të parashikuara nga ligjet e Republikës së Shqipërisë. Për t'u kualifikuar për financim sipas Grantit, prokurimi i punëve, shërbimeve dhe mallrave të kryera në përputhje me sa më sipër duhet të jetë në pajtim me Udhëzimet e Prokurimit. Në veçanti, Plani i Prokurimit (ku një term i tillë është përcaktuar në Udhëzimet e Prokurimit) (dhe çdo përditësim i tij) që tregon metodat e prokurimit për secilën kontratë, do t'i paraqitet CEB-it për miratim. Pas marrjes, CEB-i do të informojë Përfituesin për objektin e shqyrtimit që CEB-i do të kryejë për çdo kontratë.

4.6.4. Përfituesi do të sigurojë që AKSHI do të përditësojë Planin e Prokurimit, sipas nevojës, gjatë zbatimit të Projektit të Grantit. Plani i Prokurimit do të zbatohet në mënyrën që është miratuar nga CEB-i. Çdo rishikim i propozuar në Planin e Prokurimit do t'i jepet CEB-it për miratim paraprak nga ana e tij.

4.6.5. Përfituesi (drejtpërdrejt ose nëpërmjet AKSHI ose MAS) do të informojë menjëherë CEB-in për çdo vonesë ose ndryshim tjetër në planifikimin e procesit të prokurimit që mund të ndikojë ndjeshëm në zbatimin në kohë dhe të suksesshëm të Projektit të Grantit dhe do të dakordësohet me CEB-in për masat korrigjuese.

4.6.6. CEB-i nuk do të financojë shpenzime për punë, furnizime dhe/ose shërbime që nuk janë prokuruar në përputhje me dispozitat e mësipërme. Në raste të tilla, CEB-i rezervon të drejtën të deklarojë kontratën përkatëse të papërshtatshme për financim me Grantin.

- 4.6.7. Edhe nëse kontrata është dhënë pas marrjes së "asnjë kundërshtim" nga CEB-i, CEB-i mund të deklarojë përsëri prokurim të gabuar nëse arrin në përfundimin se "asnjë kundërshtim" është lëshuar në bazë të informacionit jo të plotë, të pasaktë ose çorientues të dhënë nga Përfituesi, ose termat dhe kushtet e kontratës ishin modifikuar pa miratimin e CEB-it. Në raste të tilla, CEB-i mund të kërkojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të Grantit.
- 4.6.8. Në çdo rast, përgjegjësia për dhënien dhe administrimin e kontratave sipas Projektit të Grantit mbetet tek Përfituesi.
- 4.7. Pronësia, e drejta e përdorimit të rezultateve dhe transferimi i pajisjeve.*
- 4.7.1. Sipas Nenit 11 (*Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të Dhënave*), pronësia, titulli dhe të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale të rezultateve të Projektit të Grantit, duke përfshirë raportet dhe dokumentet e tjera në lidhje me të, do t'i kalojnë përfituesit, sipas rastit, së bashku me palët e treta ose siç bihet dakord ndryshe nga CEB-i.
- 4.7.2. Pavarësisht nga dispozitat në Nenin 4.7.1 më sipër, Përfituesi do të japë dhe do të marrë masa për të siguruar që pala e tretë e interesuar t'u japë donatorëve të CEB-it dhe EWBIF-së, të drejtën për të përdorur pa pagesë ato rezultate të përmendura në Nenin 4.7.1 më sipër të cilat janë subjekt i të drejtave të pronësisë industriale ose intelektuale.
- 4.8. Përfituesi do të sigurojë që të gjitha tokat, të drejtat e pronës së paluajtshme dhe lejet e kërkuara për zbatimin e Projektit të Grantit janë në dispozicion në kohë.
- 4.9. Përfituesi do të sigurojë që të gjitha asetet dhe impiantet në kuadër të Projektit të Grantit sigurohen, vendosen në funksion dhe mirëmbahen në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Neni 5

Sipërmarrjet e mëtejshme: Angazhimi për Integritet, Mbrojtja Mjedisore dhe Sociale dhe të Drejtat e Njeriut

5.1. *Integriteti*

5.1.1. Përfituesi merr përsipër:

- (a) të krijojë dhe më pas të zbatojë politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, me qëllim që të parandalojë që Përfituesi të bëhet, në lidhje me zbatimin e Projektit të Grantit ose ndryshe, një instrument për pastrim parash, financim terrorizmi, shmangie tatimore, mashtrim fiskal, evazion fiskal, vjedhje ose çdo përdorim tjetër të paligjshëm të fondeve;
- (b) nuk do të vendosë asnjë të ardhur nga granti në dispozicion ose në përfitim të, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë Personi të Sanksionuar; dhe

- (c) nuk do të kryejë dhe asnjë person, me pëlqimin e ose dijeninë e tij paraprake, nuk do të kryejë, në lidhje me zbatimin e Projektit të Grantit, ekzekutimin e ndonjë kontrate në bazë të Projektit të Grantit ose ndryshe, një Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese, Praktikë Shtrenguese, Praktikë e Fshehtë ose Praktikë Penguese (në vijim, bashkërisht me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, shmangien e taksave, mashtrimin fiskal, evazionin fiskal, vjedhjen, çdo përdorim tjetër të paligjshëm të fondeve ose vënien në dispozicion të të ardhurave nga Granti për Personat e Sanksionuar të referuar si **“Praktika të Ndaluar”**).

Për qëllimet e Marrëveshjes:

- a. **“Praktikë korruptive”** do të thotë çdo veprim i ofrimit, dhënies, marrjes ose kërkimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një pale tjetër.
- b. **“Praktikë mashtruese”** do të thotë çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje një person, me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi;
- c. **“Praktikë shtrenguese”** dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një palë apo pronë të ndonjë pale për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një pale;
- d. **Praktikë e Fshehtë:** është një marrëveshje midis dy apo më shumë palëve, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një pale tjetër;
- e. **“Praktikë Penguese”** do të thotë në lidhje me një hetim për një Praktikë Shtrenguese, Praktikë të Fshehtë, Praktikë Korruptive ose Praktikë Mashtruese në lidhje me këtë Grant ose Projektin e Grantit, (a) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore; (b) çdo akt kërcënimi, ngacmimi ose frikësimi i ndonjë pale për ta penguar atë të tregojë informacionin që ajo palë është në dijeni për çështjet që kanë lidhje me hetimin, ose nga ndjekja e hetimit, dhe/ose (c) çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e të drejtave kontraktuale të auditimit ose aksesit në informacion.
- f. **“Vjedhje”** do të thotë përvetësimi i pasurisë që i përket një pale tjetër.

5.1.2. Hetimet dhe Raportimi i Integritetit

(a) Përfituesi ndërmerr :

- (i) të informojë CEB-in nëse ai vihet në dijeni për ndonjë mospërbushje të pretenduar ose faktike për zbatimin e dispozitave të specifikuara në Nenin 5.1 (*Integriteti*);
- (ii) të ndërmarrë veprime të tilla që CEB-i mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të hetuar dhe/ose ndërprerë ndonjë akt të pretenduar ose aktual ose mospërbushje në përputhje me dispozitat e përcaktuara në Nenin 5.1 (*Integriteti*);
- (iii) të lehtësojë çdo hetim që CEB-i mund të kryejë në lidhje me ndonjë akt të tillë ose mospërputhje me dispozitat e përcaktuara në Nenin 5.1 (*Integriteti*);

(iv) të informojë CEB-in për masat e marra për të kërkuar dëmtshpërblim nga personat përgjegjës për çdo humbje që rezulton nga ndonjë veprim i tillë ose mospërputhje me dispozitat e përcaktuara në Nenin 5.1 (*Integriteti*); dhe

(v) të informojë CEB-in gjatë zbatimit të Projektit të Grantit, kur vihet në dijeni se informacioni i transmetuar duhet të korrigjohet, përditësohet ose hiqet.

5.1.3. *Sistemi i Kontraktimit, Zbulimit të Hershëm dhe Përfundimit.*

(a) Përfituesi do të sigurojë që AKSHI dhe MAS të përjashtojnë subjektet nga dhënia e kontratave në batë të Projektit të Grantit, nëse vihet në dijeni se këto subjekte ose persona që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrëse ose kontrolli mbi të:

(i) kanë qenë objekt i një vendimi të formës së prerë ose i një vendimi administrativ përfundimtar për përfshirje në ndonjë Praktikë të Ndalar, punë të fëmijëve, trafikim të qenieve njerëzore, anashkalim të detyrimeve fiskale, sociale ose të ndonjë detyrimi tjetër ligjor të zbatueshëm, përfshirë nëpërmjet krijimit të një subjekti për këtë qëllim ose më përgjithësisht për përfshirje në një organizatë kriminale;

(ii) kanë qenë objekt i një vendimi përfundimtar ose i një vendimi administrativ përfundimtar për një parregullsi që prek interesin financiar të BE-së;

(iii) janë fajtorë për keqinterpretim në dhënien e informacionit të kërkuar, si kusht për pjesëmarrjen në procedurë ose nëse nuk e japin këtë informacion;

(iv) kanë qenë subjekt i një vendimi të formës së prerë ose i një vendimi administrativ të formës së prerë që me anë të së cilit është vendosur se subjektet kanë krijuar një njësi ekonomike nën një juridiksion tjetër me qëllim anashkalimin e detyrimeve fiskale, sociale ose çdo detyrim tjetër ligjor të zbatimit të detyrueshëm në juridiksionin e zyrës të tij të regjistruar, administratës qendrore ose vendit kryesor të biznesit;

(v) janë krijuar me qëllimin e përshkruar në pikën (iv) më sipër, siç është vendosur me një vendim i formës së prerë ose me një vendim administrativ përfundimtar; ose

(vi) janë Persona të Sanksionuar.

(b) Përfituesi merr përsipër të (1) dokumentojë çdo kërkim, provë dhe verifikime në lidhje me pikat (i) deri (vi) më sipër; dhe (2) të informojë çdo palë të tretë që gjendet në një nga situatat e përmendura më sipër, se të dhënat e saj do t'i transmetohen CEB-it dhe se mund të përfshihen në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe të Përfundimit dhe të publikohen në faqen e internetit të Komisionit Evropian.

Për qëllimet e këtij paragrafi:

“Sistemi i Zbulimit të Hershëm dhe Përfundimit” do të thotë sistemi i krijuar nga Rregullorja (BE, Euratom) nr. 2015/1929 e datës 28 tetor 2015, e ndryshuar ose zëvendësuar më tej, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Unionit (OJ L 286/1, 30.10.2015) i cili përfshin informacion mbi zbulimin e hershëm të rreziqeve që kërcënojnë interesat financiare të BE-së, për rastet

e përjashtimit nga financimi i BE-së të personave juridikë dhe fizikë dhe për rastet e vendosjes së penaliteteve financiare, siç mundësohet në faqen zyrtare të BE-së.:

https://ec.europa.eu/info/strategy/eu-budget/hoë-it-works/annual-lifecycle/implementation/antifraud-measures/edes/database_en, ose në ndonjë faqe pasuese, e

ndryshuar dhe plotësuar herë pas here.

5.1.4. Drejtori i Koordinimit të Agjendës Dixhitale dhe Projekteve të E-Qeverisjes të financuara nga jashtë të AKSHI si përfaqësues në emër të Përfituesit për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje në këto çështje do të jetë përgjegjës për kontaktet me CEB-in për qëllimet e Nenit 5.1 (*Integriteti*).

5.2. *Mbrojtjet mjedisore dhe sociale.* Zbatimi i Projektit të Grantit do të jetë në përputhje me Politikën e Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale të CEB-it.

5.3. *Të drejtat e njeriut.* Zbatimi i Projektit të Grantit nuk do të çojë në shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane.

Neni 6

Kërkesat për informacion

6.1. *Dokumentet që duhen mbajtur.* Përfituesi merr përsipër (i) të mbajë për kontroll nga CEB-i, BE-ja ose çdo organ tjetër kompetent i BE-së, për një periudhë prej gjashtë (6) vjetësh nga Data e Përfundimit, origjinalin e secilës kontratë të financuar me anë të Grantit, si dhe të gjitha dokumentet materiale që lidhen me procesin e prokurimit dhe ekzekutimin e kontratës, duke përfshirë dokumentacionin e veprimeve të ndërmarra sipas Nenit 5.1.3 (*Sistemi i Kontraktimit dhe Zbulimit të Hershëm dhe Përjashtimit*), dhe (ii) të sigurojë që Kontraktorët e tij të ruajnë në ambientet e tyre, për kontroll nga CEB-i, BE-ja ose çdo organ tjetër kompetent i BE-së, për një periudhë gjashtë (6) vjeçare nga data e përfundimit, origjinalet e kontratave që kanë lidhur me çdo nënkontraktor ose furnizues të financuar me anë të Grantit.

6.2. *Regjistrat kontabël që duhet të ruhen.* Përfituesi ruan regjistrat kontabël në lidhje me Projektin e Grantit, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke treguar, në çdo moment, ecurinë e Projektit të Grantit, dhe të cilat do të regjistrojnë të gjitha veprimet e kryera dhe do të identifikojnë asetet e financuara me ndihmën e Grantit. Këto të dhëna kontabël dhe çdo informacion financiar përkatës në lidhje me Projektin e Grantit do të mbahen për kontroll nga CEB-i, BE-ja ose çdo organ tjetër kompetent i BE-së, për një periudhë prej gjashtë (6) vjetësh nga Data e Përfundimit.

6.3. *Detyrimi për t'iu përgjigjur kërkesës për informacion.* Përfituesi merr përsipër t'i përgjigjet, brenda një periudhe të përcaktuar nga CEB-i, çdo kërkesë për informacion dhe t'i sigurojë CEB-it çdo dokumentacion që CEB-i duhet ta çmojë të nevojshme për zbatimin e duhur të Projektit të Grantit, përfshirë, ndër të tjera, raportet e auditimit, raportet e mbikëqyrësit/inxhinierit, deklaratat e kontabilitetit si dhe informacionin në lidhje me monitorimin e Projektit të Grantit dhe përdorimin e Grantit.

6.4. *Detyrimi për të informuar.* Përfituesi do të informojë CEB-in menjëherë për çdo ndryshim legjislativ ose rregullator në sektorët që lidhen me Projektin e Grantit, dhe në një kuptim të përgjithshëm, për çdo ngjarje që mund të ketë një ndikim material negativ në ekzekutimin e

detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë fakti ose ngjarje që mund të pengojë përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tij sipas këtij ligji. Çdo rast ose mospërmbushje për të informuar CEB-in për këtë mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të Grantit.

Article 7

Monitorimi dhe Raportet

7.1. Lidhur me Projektin e Grantit

(a) Përfituesi merr përsipër të paraqesë:

(i) Progres Raportet vjetore sipas Shtojcës C ("**Progres Raportet**"): (i) mbi zbatimin e Projektit të Huasë dhe Projektit të Grantit më 15 janar të çdo viti, deri në Datën e Përfundimit dhe (ii) së bashku me kërkesën për disbursimin e një Transhi të ri.

(ii) Raporti i përfundimit brenda tre (3) muajve pas Datës së Përfundimit në bazë të Projektit të Grantit (siç përcaktohet në Shtojcën A) ("**Raporti i Përfundimit**"). Raporti i Përfundimit do të përfshijë një vlerësim të performancës së Projektit të Grantit kundrejt objektivave të rënë dakord bashkërisht nga Përfituesi dhe CEB-i, si dhe një vlerësim të përdorimit dhe ndikimit të Grantit.

(iii) Progres Raportet dhe Raporti i Përfundimit duhet të mbulojnë të paktën informacionin që ndodhet në modelin e dhënë në Shtojcën C të kësaj Marrëveshjeje. Raporti i Përfundimit do të përfshijë një vlerësim të performancës së Projektit të Grantit kundrejt objektivave, si dhe një vlerësim të përdorimit dhe ndikimit të Grantit WBIF.

(b) Raportimi për shpenzimet e shkaktuara do të shprehet në EURO ose, nëse pagesat bëhen në ndonjë valutë tjetër, duke i konvertuar shumat përkatëse në EURO me kursin e "blerjes" në datën e konvertimit të valutës, siç është publikuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë.

7.2 Në lidhje me Përfituesin

Përfituesi do të informojë në përgjithësi CEB-in për çdo fakt ose rast që mund të pengojë përmbushjen e ndonjë detyrimi të Përfituesit sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.3 Monitorimi, vlerësimi dhe auditimi

7.3.1 Përfituesi ndërmerr të pranojë në mënyrë të favorshme çdo auditim të kryer nga çdo përfaqësues ose agjent i autorizuar i (i) CEB-it dhe (ii) BE-së, duke përfshirë ndonjë nga organet e tij kompetente, ose (iii) audituesit e jashtëm të punësuar nga CEB-i ose BE-ja, duke përfshirë çdo organ kompetent të saj, dhe të sigurojë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për auditimin e tyre, duke lehtësuar çdo vizitë të mundshme. Në veçanti, CEB-i, BE-ja, duke përfshirë Gjykatën e tij të Audituesve, Zyrën Kundër Mashtrimit të BE-së (OLAF), Komisionin Evropian dhe çdo organ tjetër kompetent të BE-së, mund të kryejnë një auditim në terren të Projektit të Grantit nga një ose më shumë konsulentë sipas zgjedhjes së tij, duke përfshirë në rastin e mospajtueshmërisë nga Përfituesi të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.3.2 CEB-i mund të punësojë auditues të jashtëm për të kryer një ose më shumë verifikime të shpenzimeve të Projektit të Grantit dhe Huasë gjatë Periudhës së Zbatimit dhe/ose një

verifikim të shpenzimeve pas dorëzimit të Raportit të Përfundimit, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe për shkak të specifikave të Projektit të Grantit.

7.3.3 Përfituesi është përgjegjës që tu japë audituesve të jashtëm të gjitha pasqyrat financiare nga Llogaria (t) e Posaçme, faturat origjinale përkatëse, Progres Raportet dhe Raportin e Përfundimit për Projektin e Grantit dhe Huasë, të cilat janë në përputhje me termat dhe kushtet e Marrëveshjes dhe të sigurojë se këto raporte mund të rakordohen me sistemin e kontabilitetit dhe mbajtjes së kontabilitetit të Përfituesit dhe me llogaritë dhe të dhënat themelore. Përfituesi është përgjegjës për dhënien e informacionit të mjaftueshëm dhe të duhur, financiar dhe jofinanciar, në mbështetje të raporteve. Përfituesi pranon se aftësia e audituesit të jashtëm për të kryer procedurat e kërkuara në bazë të auditimit ose verifikimit të shpenzimeve varet në mënyrë të efektshme nga Kontraktorët e tij që japin akses të plotë dhe të lirë për stafin e Përfituesit dhe sistemin e tij të kontabilitetit dhe mbajtjes së kontabilitetit, si dhe llogaritë dhe regjistrat bazë.

7.3.4 Nëse Përfituesi nuk arrin të përmbushë ndonjë nga angazhimet e tij sipas Marrëveshjes, Përfituesi merr përsipër të pranojë në mënyrë të favorshme çdo auditim në vend, të kryer nga anëtarët e stafit të CEB-it ose palët e treta të caktuara, që do të përballohet me shpenzimet e Përfituesit.

7.4. *Shpërndarja e dokumenteve.* Përfituesi pranon se CEB-i mund të jetë i detyruar të zbulojë dokumente në lidhje me Përfituesin dhe konsulentët në Bashkimin Evropian (BE), përfshirë Komisionin Evropian, Gjykatën e Audituesve të Bashkimit Evropian, Zyrën Kundër Mashtrimit të BE-së (OLAF) dhe çdo organ tjetër kompetent të Bashkimit Evropian, sipas nevojës për kryerjen e detyrave të tyre në përputhje me të drejtën e BE-së.

Neni 8

Taksat dhe detyrimet e tjera

8.1. *Taksat.* Përfituesi paguan të gjitha taksat, tatimet, detyrimet ose tarifatat të çfarëdo natyre, duke përfshirë tarifën e pullës dhe tarifatat e regjistrimit që lindin nga ekzekutimi, zbatimi, përfundimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve në lidhje me të, në përputhje me ligjet e brendshme në fuqi.

8.2. *Detyrime të tjera.* Përfituesi do të përballojë tarifatat e veta profesionale dhe bankare dhe çdo tarifë transferimi ose shkëmbimi, të shkaktuar gjatë ekzekutimit, implementimit, përfundimit ose zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe Projektit të Grantit.

Neni 9

E drejta për të pezulluar, anuluar dhe kërkuar shlyerjen e Grantit

9.1. *E drejta për të pezulluar ose anuluar.* CEB-i rezervon të drejtën të pezullojë ose anulojë çdo pjesë të papërdorur financiarisht të Grantit në cilëndo nga rrethanat e mëposhtme. Përpara se të ushtrojë të drejtën e tij, CEB-i do t'i dërgojë njoftim Përfituesit me anë të së cilit e lejon Përfituesin të paraqesë vërejtjet brenda një periudhe jo më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë.

(a) *Shkelja e detyrimit sipas kësaj Marrëveshjeje.* Nëse Përfituesi nuk përmbush ndonjë detyrim material që i është vendosur, brenda një kohe të specifikuar në mënyrë të arsyeshme (në çdo rast jo më pak 45 ditë) në një njoftim paraprak me shkrim që CEB-i i dërgon Përfituesit nëpërmjet të cilës kërkohet pajtueshmëri;

(b) *Ndryshimi material negativ.* Kur lind një situatë e jashtëzakonshme (p.sh. forca madhore, të tilla si trazirat civile, veprimet ushtarake, fatkeqësitë natyrore dhe rrethana të tjera që janë jashtë kontrollit të Përfituesit) ose ndonjë rrethanë tjetër që sipas opinionit të CEB-it e bën përmbushjen e detyrimeve të Përfituesit të pasigurt;

(c) *Shkelja e detyrimit.* Kur Përfituesi nuk përmbush, brenda një kohe të përcaktuar në mënyrë të arsyeshme në një njoftim që CEB-i i dërgon Përfituesit, nëpërmjet të cilës kërkohet pajtueshmëri, një detyrim që rrjedh nga donjë marrëveshje granti, marrëveshje huaje ose marrëveshje garancie e lidhur midis CEB-it dhe Përfituesit, dhe kur CEB-i e çmon se interesat dhe objektivat e tij cenohen në këtë mënyrë;

(d) *Anëtarësimi në CEB.* Kur Përfituesi (si huamarrës ose garantues ose përfitues i grantit) pushon së qeni anëtar i CEB-it ose nëse vendi ku zbatohet Projekti i Grantit pushon së qeni anëtar i CEB-it;

(e) *Pezullimi ose përfundimi.* Kur financimi i Grantit pezullohet ose ndërpritet në përputhje me kushtet e Kushteve të Përgjithshme ose ndonjë Marrëveshjeje përkatëse Kontributi (siç përcaktohet në Kushtet e Përgjithshme).

9.2. *E drejta për të kërkuar Shlyerje.* Në rast të shkeljes së një detyrimi sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas Nenit 9.1(a) (*Shkelja e detyrimit sipas kësaj Marrëveshjeje*) më sipër, CEB-i rezervon të drejtën të kërkojë shlyerje të menjëhershme dhe të plotë ose të pjesshme të Grantit.

9.3. *Të drejta të tjera sipas Ligjit.* Nenet 9.1 dhe 9.2 nuk kufizojnë asnjë të drejtë tjetër të CEB-it për të kërkuar shlyerjen e Grantit.

Neni 10

Detyrimet e Palëve

Përfituesi do të zhdëmtojë CEB-in ndaj të gjitha dëmeve, humbjeve, kostove dhe shpenzimeve të pësuar ose të shkaktuara nga CEB-i, *ndër të tjera*, si rezultat i ndonjë veprimi ose mosveprimi të kryer nga Përfituesi, nga mospërmbushja nga ana e tij e ndonjë prej detyrimeve të tij të specifikuara në këtë Marrëveshje, për pakujdesinë e rëndë nga ana e tij, për çdo veprim të keqpërdorimit të qëllimshëm dhe për çdo veprim mashtrues.

Neni 11

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

- 11.1 CEB-i do të trajtojë çdo informacion që i është dhënë nga Përfituesi në përputhje me detyrimet e këtij të fundit bazuar në Politikën e tij të Informacionit Publik. Përfituesi do të ruajë konfidencialitetin e çdo dokumenti, informacioni ose materiali tjetër që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e Projektit të Grantit që komunikohet nga CEB-i si "konfidencial". Natyra konfidenciale e një dokumenti nuk do të pengojë që ai t'i komunikohet një pale të tretë kur ligji detyrues për Përfituesin e kërkon këtë.
- 11.2 Përpunimi i të dhënave personale në lidhje me Marrëveshjen do të kryhet nga CEB-i në përputhje me Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave. Përfituesi do të sigurojë që të dhënat personale:
- (i) përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente në lidhje me subjektin e të dhënave;
 - (ii) mbliidhen për qëllime të specifikuar, të qarta dhe legjitime dhe nuk përpunohen më tej në një mënyrë që është e papajtueshme me ato qëllime;
 - (iii) janë të përshtatshme, të duhura dhe të kufizuara në atë që është e nevojshme në lidhje me qëllimet për të cilat ato përpunohen;
 - (iv) janë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të përditësuara;
 - (v) mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për jo më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale; dhe
 - (vi) përpunohen në një mënyrë që garanton sigurinë e duhur të të dhënave personale, duke përfshirë mbrojtjen kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe kundër humbjes, shkatërrimit ose dëmtimit aksidental, duke përdorur masat e duhura teknike ose organizative.

Neni 12

Përfaqësimet dhe garancitë

- 12.1. Përfituesi përfaqëson dhe garanton:
- (i) se është i autorizuar rregullisht të lidhë Marrëveshjen dhe i ka dhënë nënshkruesit (ve) autorizimin për këtë, në përputhje me ligjet, dekretet, rregulloret dhe tekstet e tjera të zbatueshme për të;
 - (ii) se hartimi dhe zbatimi i Marrëveshjes nuk bie ndesh me ligjet, dekretet, rregulloret dhe tekstet e tjera të zbatueshme për të; në veçanti, se është në përputhje me ligjet mbi mashtrimin, korrupsionin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, parandalimin e shmangies së taksave, mashtrimin tatimor ose evazionin fiskal dhe nuk hyn në marrëdhënie biznesi me Persona të Sanksionuar;

- (iii) nuk është dhe asnjë anëtar i organit të tij drejtues ose asnjë nga zyrtarët, drejtorët, agjentët ose punonjësit e tij nuk është person i sanksionuar ose nuk është subjekt i një vendimi gjyqësor të formës së prerë dhe të parevokueshëm në lidhje me Praktikat e Ndaluar të kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tij profesionale dhe asnjëri prej tyre nuk ka pasur dhe nuk ka hyrë në marrëdhënie biznesi me Persona të Sanksionuar;
- (iv) se ka marrë një kopje dhe është në dijeni të Udhëzimeve të Prokurimit të CEB-it, Politikës së Mbrojtjes Mjedisore dhe Sociale të CEB-it, Politikës së Informacionit Publik, Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave, Kartës Kundër Korrupsionit dhe Politikës për Juridiksionet jo në përputhje/jo bashkëpunuese.

12.2. Nëse ndonjë nga përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme është ose provohet se ka qenë i pasaktë ose mashtrues në ndonjë aspekt gjatë kohëzgjatjes së Grantit, CEB-i mund të ushtrojë ndonjë nga të drejtat e tij sipas Nenit 9 (*E drejta për të pezulluar, anuluar dhe kërkuar shlyerjen e Grantit*).

Neni 13 **Njoftimet**

13.1. Çdo njoftim (përfshirë çdo dokument ose komunikim) që do t'i jepet ose bëhet në bazë ose në lidhje me këtë Marrëveshje për CEB-in ose Përfituesin, do të jetë me shkrim dhe nëse nuk përcaktohet ndryshe, mund të bëhet me letër rekomande, postë elektronike. Një njoftim i tillë do të konsiderohet se është marrë nga Pala tjetër:

- i. në datën e dorëzimit në lidhje me një letër të dorëzuar personalisht ose me letër rekomande;
- ii. në rastin e postës elektronike, vetëm kur është marrë në formë të lexueshme dhe vetëm nëse adresohet në atë mënyrë siç e specifikon Pala tjetër për këtë qëllim;

13.2. Çdo njoftim që Përfituesi i jep CEB-it me postë elektronike, duhet:

- i. të ketë referencën e Marrëveshjes në rreshtin e lëndës;
- ii. të jetë në formën e një imazhi elektronik të pa-redaktueshëm (pdf, tif ose një format tjetër skedari të përbashkët të pa-redaktueshëm të rënë dakord ndërmjet Palëve) të njoftimit të nënshkruar nga personi ose personat e autorizuar për të nënshkruar këtë njoftim në emër të Përfituesit, bashkëngjitur postës elektronike.

13.3. Pa cenuar vlefshmërinë e njoftimeve me postë elektronike, të bëra në përputhje me këtë Nen, njoftimet e mëposhtme, do t'i dërgohen gjithashtu me letër rekomande Palës tjetër maksimumi në Ditën e Punës menjëherë vijuese:

- i. kërkesat për disbursim;
- ii. çdo komunikim në lidhje me pezullimin, anulimin ose shlyerjen e Grantit; dhe
- iii. çdo komunikim tjetër të kërkuar nga CEB-i.

13.4 Palët bien dakord që çdo njoftim i mësipërm (përfshirë përmes postës elektronike) është një formë e pranuar komunikimi, do të përbëjë provë të pranueshme në gjykatë dhe do të ketë të njëjtën vlerë provuese si një marrëveshje në fjalë.

13.5 Adresa postare dhe adresa e postës elektronike (dhe departamenti ose zyrtari, nëse ka, në vëmendjen e të cilit duhet të bëhet komunikimi) e secilës Palë për çdo komunikim që do të jepet ose bëhet sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, është:

Për Përfituesin:

Adresa: Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr.3, Tiranë, Shqipëri

E-mail: sekretariamin@financa.gov.al

Në vëmendje të: Ministrit të Financave

Kopje për: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Adresa: Rruga Papa Gjon Pali II 3, Tiranë

E-mail: romina.kostani@akshi.gov.al

Në Vëmendje të: Romina Kostani, Drejtore e Koordinimit të Agjendës Dixhitale dhe Projekteve të E-Gov të financuara nga jashtë

Për CEB-in:

Adresa:

Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës

55, avenue Kléber

75784 Paris Cedex 16 – France

Drejtuar: Drejtor Divizioni i Projekteve, Drejtoria për Huadhënie dhe Zhvillim Social

E-mail: projects@coebank.org

13.6. CEB-i dhe Përfituesi do të njoftojnë menjëherë Palën tjetër me shkrim për çdo ndryshim në detajet e tyre përkatëse të komunikimit.

13.7. Të gjitha njoftimet që do të jepen ose bëhen në bazë të ose në lidhje me Marrëveshjen, do të jenë në anglisht ose nëse janë në një gjuhë tjetër, do të shoqërohen me një përkthim të certifikuar në anglisht, kur kërkohet nga CEB-i.

13.8. Të gjitha njoftimet që do të jepen ose bëhen nga Përfituesi sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje, kur kërkohet nga CEB-i, do t'i dorëzohen CEB-it së bashku me dëshmi të pranueshme

të autoritetit të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar një njoftim të tillë në emër të Përfituesit dhe nënshkrimin model të vërtetuar të personit ose personave të tillë.

Neni 14

Ndryshimet dhe rishikimet e buxhetit

- 14.1. Kjo Marrëveshje mund të modifikohet me amendament me shkrim të nënshkruar nga CEB-i dhe Përfituesi. Amendamentet që sjellin një modifikim të FAG-ut, mund të jenë objekt i miratimit të Donatorit.
- 14.2. *Rishikimet e buxhetit.* Palët bien dakord që (i) rishikimet e thjeshta buxhetore (duke përjashtuar në çdo rast rialokimet ndërmjet Asistencës Teknike dhe Grantit të Investimeve) të cilat nuk ndikojnë në qëllimin kryesor dhe që nuk riallokojnë më shumë se njëzet për qind (20%) ndërmjet titujve buxhetorë të rënë dakord nga Përfituesi dhe të rënë dakord më pas nga CEB-i, janë të pranueshme dhe (ii) Përfituesi do të kërkojë miratimin e CEB-it përpara çdo riallokimi buxhetor midis titujve buxhetorë që tejkalon këtë prag njëzet për qind (20%) ose që ndikon në ndonjë shpërndarje fondesh ndërmjet linjave të buxhetit të Asistencës Teknike dhe Grantit të Investimeve.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 15.1. Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me Marrëveshjen, duke përfshirë ekzistencën, vlefshmërinë, interpretimin ose përfundimin e saj, do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve.
- 15.2. Në mungesë të zgjidhjes me mirëkuptim, mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve në lidhje me Marrëveshjen do t'i nënshtrohen arbitrazhit sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Shtojcën E të kësaj marrëveshjeje (*Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve*).
- 15.3. Asgjë në ose në lidhje me këtë Marrëveshje nuk do të konsiderohet heqje dorë (e shprehur ose e nënkuptuar) e ndonjë prej privilegjeve dhe imuniteteve të CEB-it të parashikuar në Protokollin e Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Privilegjet dhe Imunitetet të Këshillit të Evropës.

Neni 16

Paligjshmëria dhe Përfundimi i Parakohshëm

- 16.1 *Paligjshmëria.* Nëse është ose bëhet e paligjshme në ndonjë juridiksion që CEB-i të japë, të mbajë ose të financojë Grantin ose të përmbushë ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, CEB-i mund të ushtrojë cilëndo nga të drejtat e tij sipas Nenit 9 (*Rikuperimi, e drejta për të pezulluar, anuluar dhe kërkuar shlyerjen e Grantit*).
- 16.2 *Përfundimi i Parakohshëm.* Marrëveshja mund të ndërpritet në çdo kohë nga CEB-i përpara Datës së Përfundimit, duke i dhënë njoftim Përfituesit të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë para. Çdo shumë e mbetur e pashpenzuar dhe e papërdorur financiarisht në datën e përfundimit të hershëm ose çdo shlyerje e Grantit në përputhje me Marrëveshjen, do të përpunohet në përputhje me nenin 2.1.6 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të specifikuar në konfirmimin me shkrim nga Huamarrësi drejtuar CEB-it që konfirmon përmbushjen e procedurave të saj të brendshme siç përshkruhet më tej në pikën 1.4.1(b) më sipër, pas nënshkrimit të Marrëveshja nga palët.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar Marrëveshjen në gjuhën angleze në dy (2) origjinale.

Nëse kjo Marrëveshje nënshkruhet në ndonjë gjuhë tjetër përveç gjuhës angleze, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Nënshkruar më 23.09.2024

Për Përfituesin:

Emri: PETRIT MALAJ

Titulli: MINISTER I FINANCAVE

Nënshkrimi

.....

Nënshkruar në Paris, më 17.07.2024

Për CEB-in:

Emri: GLISOVIC JASMINA

Emri: Patrick Radhauer

Titulli: Drejtues Divisioni

Titulli: Drejtues Divisioni

SHTOJCAT

Shtojca A: Përshkrimi i Projektit të Grantit

Shtojca B: Kërkesa për disbursimin e Transhit të Grantit (Modeli)

Shtojca C: Raporti i Përfundimit/Progres Raporti i kombinuar për Projektin e Huasë dhe Projektin e Grantit (Model)

Shtojca D: Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit

Shtojca E: Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Shtojca A: Përshkrimi i Projektit të Grantit:

Projekti i Grantit	Krijimi i Laboratorëve Inteligjentë (Smart Labs) - Rrjeti i Laboratorëve të TIK-ut për Sistemin Arsimit Parauniversitar
Përfituesi	Shqipëria
Autoriteti përgjegjës i Përfituesit	1. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)
Subjekti (t) zbatues	1. Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) 2. Ministria e Arsimit dhe Sportit
Përfituesit përfundimtarë	Fëmijë dhe studentë në Shqipëri
Miratuar nga Komiteti Drejtues i WBIF-it	13 janar 2023
Shuma e Grantit të disponueshëm EWBIF	10,137,811.00 Euro (pa përfshirë tarifën e menaxhimit të CEB-it)
Vendndodhja	Shqipëri
Objekti i Projektit të Grantit	Objekti i përgjithshëm i Projektit të Grantit është zhvillimi i Arsimit Dixhital në Shqipëri nëpërmjet: • rritjes së disponueshmërisë së laboratorëve me kompjutera për studentët në ciklet e tyre parauniversitare; dhe • sigurimit të mjeteve të nevojshme për të rritur aftësitë e programimit kompjuterik për të rinjtë studentë. Projekti, siç u prezantua fillimisht në Asambleenë e Kontribuesve të WBIF-it, u projektua për të ofruar 684 Laboratorë Inteligjentë TIK (Smart ICT Labs) për 627 shkolla në të gjithë territorin shqiptar, siç specifikohet në seksionin 16.4 (Harta e projektit) të FAG-ut.

	Një Laborator Inteligjent TIK (Smart ICT Lab) përbëhet nga një dhomë modulare brenda çdo shkolle dhe që është e pajisur me karakteristikat, infrastrukturën dhe pajisjet e mëposhtme: 1. Kapaciteti maksimal: 24 ose 30 nxënës në bazë të vendndodhjes së shkollës (përkatësisht rurale ose urbane) 2. Mjedis optimal për të punuar: • I pastër: i lyer siç duhet • Lehtësisht i aksesueshëm: brenda godinës së shkollës • I ajrosur mirë: me 2 x 18,000 njësi klimatizimi BTU për mot të ftohtë dhe të nxehtë • Ndriçim i mirë: përdorimi i një rrjeti të sistemit të ndriçimit LED që kursen energji • Jo i zhurmshëm: i izoluar mirë ose larg çdo burimi zhurme • I sigurt: i mbyllur me derë të blinduar me sistem Access Control dhe monitorohet vazhdimisht duke përdorur 2 kamera dhe sistem regjistrimi DVR • I mbrojtur nga zjarri: me 4 fikëse manuale të shpërndara mirë dhe të lehta për t'u përdorur (2 kg) CO2 3. Infrastrukturë e plotë elektrike e mbrojtur mirë dhe e sigurt (kablo të fshehura, sistem i duhur tokëzimi, priza me mbrojtëse në rast mbitemensionimi) sigurimi i prizës elektrike individuale të dedikuara për të gjitha pajisjet në Smart Lab (Smart Lab). Ndërsa Laboratorët Inteligjentë (Smart Labs) aktual japin si opsion 1 komplet kompjuterash për 2 nxënës/studentë, rrjeti elektrik do të marrë parasysh; për përmirësimin e ardhshëm; një prizë të dedikuar për student. 4. Infrastrukturë e plotë, e besueshme dhe e sigurt e rrjetit lokal, duke përdorur kablo rrjeti të nivelit të lartë dhe kordonë me kapëse. Për të njëjtën arsye të lartpërmendur të përmirësimit të ardhshëm, një prize rrjeti duhet të merret në konsideratë për secilin nxënës/student dhe jo një për çdo dy nxënës/student. 5. Pajisjet e rrjetit: kabineti i rrjetit 4U, ndërprerësi Gigabit dhe Ruter 6. Lidhje e besueshme dhe e sigurt në internet me shpejtësi të lartë
--	---

	me një brez minimal prej 10 Mbits 7. Një tabelë inteligjente me definicion ultra të lartë 85" 8. Një komplet për mësuesin që ka: • Një karrige dhe një tavolinë • Një laptop me specifikime të mira (CPU I5, 8 GB RAM, 256 Gb HDD, 15,6" ekran, Webcam, Wi-Fi, min 3 USB, HDMI etj.) • Softuer original: Windows 11 OS ose ekuivalent, MS Office Home dhe Student 2021 ose ekuivalent, mjete programimi • Një mikro-kompjuter për qëllime kodimi • Një mbajtëse laptopi 9. Kompletet e nxënësve që kanë për çdo 2 nxënës: • Një tavolinë dopio dhe 2 karrige individuale • Një laptop me specifikime të mira (CPU I5, 8 GB RAM, 256 Gb HDD, ekran 15,6", Webcam, Wi-Fi, min 3 USB, HDMI, etj.) • Softuer original: Windows 11 OS ose ekuivalent, MS Office Home dhe Student 2021 ose ekuivalent, mjete programimi • Një mikro-kompjuter për qëllime kodimi • Një mbajtëse laptopi 10. Një UPS: për të mbrojtur dhe për të mbajtur në punë Tabelën Inteligjente (Smart board) dhe pajisjet e rrjetit gjatë çdo ndërprerjeje të energjisë. Do të jetë me një specifikim të mirë (2000 VA, online, valë e pastër e sinjalit, rregullator automatik i tensionit (AVR), i montuar në raft etj.) Rezultatet e pritshme të zbatimit të Projektit të Granteve janë përshkruar në seksionin 27 të GAF-it.
Data e Fillimit	Me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje Granti
Data e Përfundimit	31.12.2028
Kostot e pranueshme	Në përputhje me nenin 2.1.2 të kësaj Marrëveshjeje Granti

Monitorimi dhe Raportimi	Në përputhje me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje Granti
---------------------------------	---

Buxheti Indikativ i Projektit

Ndarja e buxhetit të grantit të WBIF-it është si më poshtë:

	Granti WBIF
I- INVESTIMET	
Punët dhe furnizimet, duke përfshirë rastet e paparashikuara ¹	9,787,304 EURO
II- ASISTENCA TEKNIKE	
Asistenca teknike ¹	250,507 EURO
III- KOMUNIKIMI DHE VIZIBILITETI	100,000 EURO
TOTALI I PËRGJITHSHËM WBIF	10,137,811 EURO

¹ Financimi i WBIF-it nuk mund të tejkalojë 30% të kostos totale të këtij aktiviteti.

KOSTOT TOTALE TË INVESTIMEVE

Komponenti	Kategoritë e kostos (Përshkrimi)	Kostot Totale të Projektit (EURO)
1	Asistenca teknike për zbatimin e projektit	835,023
	Asistenca teknike për zbatimin e projektit (Mbikëqyrja e punimeve dhe menaxhimi i projektit)	
2	Të tjera	1,763,624
	Orendi	
3	Të tjera	18,500,000
	Pajisje TIK	
4	Punimet (Ndërtimi dhe ndërtimi)	7,586,303
	Punime civile	
5	Të tjera	32,150
	Lidhja e Internetit	
6	Të tjera	6,236,344

	Instalimi dhe vendosja në punë (pajisje për punime civile dhe TIK)	
7	Komunikimi dhe vizibiliteti	100,000
	Komunikimi dhe vizibiliteti	
8	Vlerësimi dhe Auditimi	478,236
	Vlerësimi, Auditimi & Monitorimi	
9	Rastet e paparashikuara	2,965,850
	Rastet e paparashikuara	
10	Ngritja dhe mbështetja e kapaciteteve	1,074,209
	Printimi i materialeve të trajnimit dhe kurrikulës // Zhvillimi i moduleve të trajnimit dhe trajnimi i mësuesve dhe drejtorëve	
	Kostot totale të Projektit	40,666,000

BURIMI I FONDEVE		KOMPONENTI I FINANCIAR	%	
WBIF	10,137,811 EURO	1,3,7,9	24%	
CEB	27,000,000 EURO	3,4,5,6	66%	
Kontributi kombëtar	3,428,395 EURO	2,3,8, 10	10%	

SHTOJCA B

Kërkesë për disbursimin e Transhit të Grantit (Model)

<Data, vendi>
Në vëmendje të: CEB
Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës
55 avenue Kléber
F – 75116 Paris

Titulli i Marrëveshjes së Grantit: <Vendosni titullin>
Numrat e referencës: WBIF: [] **dhe CEB:** []
Kërkesa për numrin e disbursimit: <Vendosni numrin>

I nderuar Zotëri/Zonjë,

Me anë të kësaj kërkoj disbursimin e <Vendosni numrin e Transhit> sipas Marrëveshjes së Grantit të përmendur më lart.

Shuma e kërkuar është <...> Euro.

Ju lutemi gjeni bashkëlidhur dokumentet mbështetëse të mëposhtme:

-
-

Disbursimi i Transhit të Grantit duhet të bëhet në Llogarinë e Posaçme të përmendur më poshtë:

Emri i mbajtësit:
Adresa e mbajtësit:
Numri i llogarisë IBAN:
Kodi Swift:
Emri/adresa e bankës:

Me anë të kësaj vërtetoj se informacioni që ndodhet në këtë Kërkesë për disbursimin e Transhit të Grantit është i plotë dhe i besueshëm [dhe se kostot e shkaktuara deri më sot, siç specifikohen në Raportin e Progresit, janë të pranueshme në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Grantit] [MOS PËRFSHINI PËR TRANSHIN E PARË TË GRANTIT] dhe se kjo Kërkesë për disbursimin e Transhit të Grantit është vërtetuar nga dokumente mbështetëse të përshtatshme dhe të verifikueshme.

Me respekt,

<Nënshkrues i autorizuar>

SHTOJCA C
LD 2175 (2023)

Modeli i raportimit (progresi vjetor dhe raporti përfundimtar)

WB-IG07-ALB-DII-01

TITULLI I PROJEKTIT: Krijimi i Laboratorëve Inteligjentë (Smart Labs) - Rrjeti i laboratorëve të
TIK-ut për sistemin arsimor parauniversitar

Progres Raporti

PERIUDHA RAPORTIMI: d/m/v– d/m/v

Përgatitur nga (emri dhe nënshkrimi) _____
Departamenti _____
Data _____

Tabela e Përmbajtjes

1. Raporti narrativ
 - 1.1 Përmbledhje e Projektit
 - 1.2 Aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura
 - 1.3 Perspektivat e ndikimit (do të paraqiten në raportin e përfundimit)
 - 1.4 Aktivitetet e Komunikimit dhe Vizibilitetit
 - 1.5 Devijimet nga plani dhe vështirësitë e hasura, nëse ka, dhe masat zbutëse

2. Tabelat e monitorimit

- Tabela 1: Kostot dhe burimet e financimit (të gjitha kostot janë me TVSH neto)
- Tabela 1A: KOSTOT sipas aktiviteteve të bashkëfinancuara nga WBIF (TVSH neto)
- Tabela 2: Plani i prokurimit
- Tabela 3: Lista e kontratave të dhëna
- Tabela 4: Plani i Zbatimit
- Tabela 5: Treguesit e Produktit/Rezultatit

1. Raporti Narrativ

1.1. Përmbledhje e Raportit

Titulli i Projektit		
Objektiva		
Hyrja në fuqi e Marrëveshjes Kuadër të Huasë		
Agjencia Zbatuese		
Kostot e llogaritura të Projektit	Originale:	Rishikuar:
Shuma e miratuar e huasë së CEB-it		
Financimi maksimal nga CEB-i i kostove totale të pranueshme (në përqindje)		
Burime të tjera financimi		
Periudha e zbatimit	Originale: m/v-m/v	Rishikuar:
Data e mbylljes për disbursimin e huasë së CEB-it		

1.2. Aktivitetet e ndërmarra dhe rezultatet e arritura

Ju lutem përshkruani statusin e zbatimit të aktiviteteve kyçe të projektit sipas nivelit arsimor, çështjet e hasura që kanë ndikuar në rezultatet e pritshme dhe rekomandimet e zbatuara për trajtimin e tyre, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

Aktiviteti	Progresi dhe rezultatet	Çështjet e hasura	Rekomandimet
Instalimi dhe pajisjet e Laboratorëve Inteligjentë (Smart Labs)			
-Shkollat fillore			
-Shkollat bazë			
-Shkollat nëntëvjeçare			
-Shkollat kolektive			
Aktivitetet për trajnimin e drejtorëve dhe mësuesve			
-Shkollat fillore			
-Shkollat bazë			
-Shkollat nëntëvjeçare			
-Shkollat kolektive			
Aktivitete të ndihmës teknike			
Komunikimi dhe vizibiliteti			
Monitorimi dhe Vlerësimi			

1.3 Skeduli i Përditësuar i Implementimit

Ju lutem përditësoni planin e zbatimit për çdo komponent, duke shpjeguar arsyet për vonesat, nëse ka.

1.4 Kostot e përditësuara

Ju lutem jepni me detaje çdo ndryshim në kostot e llogaritura ose të shkaktuara kundrejt buxhetit fillestar, dhe arsyet.

1.5. Prospektet e Ndikimit (duhet të paraqiten në Planin e Përmbylljes)

Jepni informacion dhe komente të duhura mbi kontributin e Projektit për të arritur objektivin e përgjithshëm.

1.6. Aktivitetet e Komunikimit dhe Vizibilitetit

1.6.1. Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit të ndërmarra gjatë periudhës raportuese

Ju lutem informoni shkurtimisht për ecurinë e arritur mbi dispozitat që lidhen me vizibilitetin, të përfshira në marrëveshjen e grantit. Ju lutem përfshini linqet e shtypit/mediave (sociale) dhe fotot e përzgjedhura (p.sh. këto të fundit për të treguar përputhjen me identitetin specifik vizual të projektit) në mbështetje të aktiviteteve.

1.6.2. Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit të planifikuara për periudhën (at) e ardhshme të raportimit

Ju lutem përfshini një planifikues me aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit, të planifikuar për periudhën (at) e ardhshme të raportimit.

1.7 Devijimet nga Plani dhe vështirësitë e hasura, nëse ka, dhe masat zbutëse

Jepni informacion mbi çdo kufizim/devijim madhor nga plani, veçanërisht, por pa u kufizuar në probleme që rrezikojnë të sjellin vonesa në projekt. Shpjegoni arsyet e këtyre devijimeve dhe propozoni masa korrigjuese në tabelën e mëposhtme.

Plani i Veprimit i Propozuar për të zgjidhur çështjet (nëse ka):			
Kufizimi/Devijimet	Masat Korrigjuese	Përgjegjës	Data e Përfundimit

TABELA 1: KOSTOT E PROJEKTIT DHE BURIMET E FINANCIMIT NË EURO (TVSH neto)

Raport i Identifikimit të Progres Raportit

Data e mbylljes së raportimit: D/M/V

Vendi: Shqipëri
Huamarrësi: Shqipëria
Projekti: LD 2175 Laboratorët Inteligjentë (Smart Labs) në shkollë

KOSTOT	Zërat e Kostos	Kontrata ref. numri (nëse është e zbatueshme)	Kostot e vlerësuara të rishikuara në EURO (nëntor 2023)	Kostot e krijuara						% e krijuar (nga kostot e rishikuara)	Kostot e parashikuara		Komente
				2024	2025	2026	2027	2028	Totali i krijuar		Deri në përfundimin	nga të cilat në 12 muajt e ardhshëm	
I	LABORATORË INTELIGJENTE (SMART LABS)		35,194,682	Në EURO	Në EURO	Në EURO	Në EURO	Në EURO	Në Euro (d)	(d) = (c) / (b)	(e) = (b) - (c)		
1	Orëmi për Laboratorë Inteligjentë (Smart Labs) në shkollë (raft 16U dhe instalim /travelinë & karrixe)		1,763,624										
2	Pajisja dhe vendosja e Laboratorëve Inteligjentë (Smart Labs) në shkollë		32,322,647										
2a	Pajisjet TIK		18,500,000										
2b	Burimet		7,586,338										
2c	Vatshimi dhe kolaudimi		6,236,344										
3	Mirëmbajtja dhe ndërrimi i pajisjeve të Laboratorëve Inteligjentë (Smart Labs) në shkollë		1,076,263										
4	Udhja me Internetin		92,150										
II	NDËRTIM, M & V		1,481,259										
5	TA për zbatimin e projektit		653,023										
6	Komunikimi dhe vizibiliteti		100,000										
7	Monitorimi & Vlerësimi		378,236										
8	Vlerësimi dhe Auditimi		100,000										
III	NDËRTIM DHE MBËSHTETJE E KAPACITETEVE		1,074,209										
	Printimi i materialeve të trajnimit dhe kurrikulës		452,174										
	Zhvillimi i moduleve të trajnimit & trajnimi i mësuesve dhe drejtorëve		622,035										
IV	RASTET E PAPARASHIKUARA		2,965,950										
	TOTALI		40,666,000										

Burimi i fondeve	KOMPONENTI I FINANCIAR
(kosto e rishikuar krahasimore)	
WBIF: 5, 6, IV	
Ceb: 3, 4	
Kontributet kombëtare	1, 2, 7, 8, III

PLAN FINANCIAR

Dhjetor 2023 (pas miratimit të grantit dhe huasë) MIL EURO		Fondet e marra						% të kostove të krijuara të financuara		Parashikuar	Komente
								% sipas burimit të financimit (aktual)			
			2024	2025	2026	2027	2028	Totali i marrë		Deri në përfundimin	Nga të cilat në 12 muajt e tjerë
BURIMET E FINANCIMIT	Granti WBIF	10	Në Euro	Në Euro	Në Euro	Në Euro	Në Euro	Në Euro		Në Euro	
	Huaja CEB	27							24		
	Buxheti kombëtar	4							66		
	TOTALI	41							10		
									100%		

TABELA 1a: KOSTOT sipas aktiviteteve të bashkë-financuara nga WBIF (TVSH neto)

Data e mbylljes së raportimit: D/M/V

Vendi: Shqipëri
Huamarrësi: Shqipëri
Projekti: LD 2175 (2023) – Laboratorët Inteligjentë (Smart Labs) në shkollë

PLAN FINANCIAR

KOSTOT E LINDURA									BURIMI I FINANCIMIT								
Artikujt e Kostos	Buxheti i planifikuar	Vlera e kontratës e nënshkruar në LC (nëse është e aplikueshme) (në LEK)	Kontrata e nënshkruar (në EURO) ¹	Ujori i faturës (paradhënie ose i përkohshëm)	Faturë numër	Data e faturës	Shuma e përkohshme e faturës në LC (nëse është e aplikueshme) (në EURO) ²	Shuma e përkohshme e faturës (në LEK)	Shuma e faturës paradhënie (në EURO) ²	Kompensimi paraprak kundrejt faturës së kostos (në EURO) ²	Shuma e faturës së Përkohshme të paguar (në EURO) ³	Data e pagesës	Granti WBIF	Huaja CEB	Kontributi financiar	Komente	
TA për zbatimin e projektit	853,023																
Pajisja dhe vendosja e smart labs	18,500,000																
Pajisjet e TIK-ut																	
Komunikimi dhe vizibiliteti	100,000																
Rastet e paparashikuara	2,965,850																

(1) Ju lutem aplikoni kursin e këmbimit në datën e nënshkrimit të kontratës
(1) Ju lutem aplikoni kursin e këmbimit në datën e faturës
(1) Ju lutem aplikoni kursin e këmbimit në datën e pagesës

TABELA 2 - PLANI I PROKURIMIT PËR VITIN XXXX (TVSH neto)

Vendi: Shqipëri
Huamarrësi: Shqipëri
Projekti: LD 2175 (2023) – Labororët Inteligjentë (Smart Labs) në shkollat

1. Punime Civile

[illegible]

2. Mallrat

[illegible]

1. Shërbimet

[illegible]

NB: Në kolonën 5, ju lutem specifikoni burimet e financimit që priten të përdoren, p.sh.: CEB, S&B Buxheti etj.
NB: Kolona 8 "Preferenca e Brendshme" duhet të plotësohet vetëm në rastin e Metodës së Prokurimit ICB. Në rastin e Metodave të tjera të Prokurimit, ju lutem vendosni "E pazbatueshme".
NB: Kolona 9 "Rishikim nga Banka" do të plotësohet nga CEB.

TABELA 3 - LISTA E KONTRATAVE TË DHËNA (pa TVSH)

Vendi: **Shqipëri**
Huamarrësi: **Shqipëri**
Projekti: **LD 2175 (2023) – Laboratorët Inteligentë (Smart Labs) në shkollat**

Data e mbylljes së raportimit: D/M/V

[illegible]

[1] Kundërvlera në Euro me kursin e mesëm të këmbimit të Bankës Kombëtare në datën e nënshkrimit të kontratës.

[2] Akronimet që do të përdoren: P për Punime, M për Mallra dhe S për Shërbime.

[3] Kundërvlera në Euro me kursin e mesëm të Bankës Kombëtare në datën e pagesës së faturës.

TABELA 4 – PLANI I ZBATIMIT

Vendi: Shqipëri
Huamarrësi: Shqipëri
Projekti: LD 2175 (2023) – Labororët Inteligentë (Smart Labs) në shkollë

Data e mbylljes së raportimit: D/M/V

Aktivitetet (lista treguese, objekt rishikimi)	2024				2025				2026				2027				2028				% e përfundimit
	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	
1 Smart Lab - instalimi - orendi - trajnim teknik në instalim - mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e smart labs	Bazë																				
	Aktuale																				
2 Veprimtari ndërtimit të kapaciteteve	Bazë																				
	Aktuale																				
3 Ndhimë teknike për NIZP-në	Bazë																				
	Aktuale																				
4 Funksionimi dhe mirëmbajtja	Bazë																				
	Aktuale																				
5 Vizibiliteti dhe komunikimi	Bazë																				
	Aktuale																				
6 Vlerësimi dhe monitorimi	Bazë																				
	Aktuale																				
	Bazë																				
	Aktuale																				
	Bazë																				
	Aktuale																				
	Bazë																				
	Aktuale																				

* Plani i zbatimit bazë - plani i paraqitur në FLA

** Plani aktual i zbatimit - plani i rishikuar në momentin e raportimit

TABELA 5- INDIKATORËT E PRODUKTIT/REZULTATIT

Huamarrësi : Shqipëri
Projekti: LD 2175 (2023) – Labororët Inteligentë (Smart Labs) në shkollë

Data e mbylljes së raportimit: D/M/V

Indikator	Njësia	Synimi i projektit	2024	2025	2026	2027	2028	Arritur me përfundimin	Komente/ Vërejtje
Numri i Laboratorëve Inteligentë (Smart Labs) në shkollë të instaluar dhe funksionalë	Nr.								
Shkollat fillore									
Shkollat bazë									
Shkollat nënëvjeçare									
Shkollat kolektive									
Numri i drejtorëve dhe mësuesve të trajnuar nga MASH	Nr.								
Shkollat fillore									
Shkollat bazë									
Shkollat nënëvjeçare									
Shkollat kolektive									
Përqindja e shkollave të pajisura me Laboratorë Inteligentë (Smart Labs) në shkollë	%								
Shkollat fillore									
Shkollat bazë									
Shkollat nënëvjeçare									
Shkollat kolektive									
Numri i studentëve që përfitojnë nga implementimi i laboratorëve të rinj inteligjentë TIK	Nr.								Burimi: WBIF FAG
Shkollat fillore									
Shkollat bazë									
Shkollat nënëvjeçare									
Shkollat kolektive									
Raporti i Totalit të Studentëve në sistemin e ciktit para - universitar mbi totalin e kompjuterëve në vend (shkollat publike)	Studentë /kompjuter								Burimi: WBIF FAG
Shkollat fillore									

Shkollat bazë									
Shkollat nënëvjeçare									
Shkollat kolektive									
% e nxënësve të klasave të hershme (1-3) në shkollat me laboratorë inteligjentë funksionalë, duke arritur kompetencat bazë minimale të aftësive dixhitale sip: përshkruhet në kurrikulat e TIK-ut	%								

SHTOJCA D Plani i Komunikimit dhe Vizibilitetit

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Të gjitha aktivitetet e komunikimit dhe të vizibilitetit të ndërmarra në lidhje me Projektin, do të jenë në përputhje me Udhëzimet e Komunikimit dhe Vizibilitetit të WBIF-it, siç vendosen në dispozicion në: <https://www.WBIF.eu/library/governance>.

Identiteti vizual dhe heqjet dorë nga përgjegjësitë

Logot e WBIF-it dhe CEB-it

WBIF ka logon dhe sloganin e vet DUKE NDËRTUAR TË ARDHMEN EVROPIANE BASHKËRISHT, si më poshtë:



Gjithashtu, nëse promovimi shtesë i fushatave të vazhdueshme të BE-së çmohet i përshtatshëm (që do të vendoset me CEB-in dhe EUD-in), mund të shtohet flamuri i BE-së dhe slogane specifike (p.sh. #EU4YOU).

Logoja e CEB-it është si më poshtë:



NB. Asnjë nga logot nuk mund të modifikohet, ndryshohet, përveç rasteve kur miratohet paraprakisht nga CEB-i. CEB-i do të vërë në dispozicion versionet me rezolucion të lartë dhe të redaktueshëm të dy logove në fillim të aktiviteteve të komunikimit dhe vizibilitetit.

Referenca specifike për WBIF-in

Duke lejuar hapësirën dhe kontekstin, në materialet e komunikimit duhet të përfshihet një shpjegim se çfarë është WBIF-i, si më poshtë:

Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) është një iniciativë e përbashkët e Komisionit Evropian, Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Bankës Evropiane të Investimeve (BEI), donatorëve dypalësh dhe perëndimorë, përfituesve të Ballkanit Perëndimor. WBIF-i u lançua në dhjetor 2009 me qëllim rritjen e harmonizimit dhe bashkëpunimit në investime për zhvillimin social - ekonomik të rajonit dhe për të kontribuar në perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Banka e Zhvillimit e KfW-së, në emër të Qeverisë Federale Gjermane (KfW) dhe Grupi i Bankës Botërore (WBG) më pas iu bashkuan platformës. Në dhjetor 2018, Agence Française de Développement

(AFD) u bë një organizatë pjesëmarrëse në WBIF. Për shkak të natyrës së tij bashkëpunuese në përputhje me qasjen "Ekipi i Evropës", WBIF është mjeti kryesor për zbatimin e Planit ambicioz Ekonomik dhe Investimeve të BE-së për Ballkanin Perëndimor 2021-2027.

Paraqitja vizuale e mëposhtme mund të shtohet dhe/ose të përdoret në mënyrë alternative, në varësi të qëllimit dhe natyrës së komunikimit:



Për të prezantuar CEB-in, mund të përdoret teksti i mëposhtëm:

CEB-i është një bankë zhvillimi shumëpalëshe me mandat social, i krijuar në vitin 1956 për të sjellë zgjidhje për problemet e refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga Lufta e Dytë Botërore. Nëpërmjet ofrimit të financimit dhe ekspertizës teknike për projekte investimi me një ndikim të lartë në jetën e njerëzve, ai promovon në mënyrë aktive kohezionin social në 42 shtete anëtare në të gjithë Evropën.

Mohimi specifik i përgjegjësi për të dorëzueshmet e komunikimit dhe vizibilitetit të përgatitura me financim nga granti i BE-së:

Ky [publikim/video, etj.] është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij [publikimi/video etj.] është përgjegjësi e vetme e [Kontraktorit] dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË KOMUNIKIMIT

Aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit do të kërkojnë:

- i. të përmirësojnë ndërgjegjësimin e përfituesve përfundimtarë për infrastrukturën e TIK-ut të vënë në dispozicion.
- ii. të sigurojnë vizibilitetin e lartë dhe përmirësimin e ndërgjegjësimit të përgjithshëm për mbështetjen e BE/WBIF për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Shqipëri, si midis taksapaguesve të BE-së dhe qytetarëve të Shqipërisë.
- iii. të informojë palët kryesore të interesit të projektit për objektivat dhe progresin e projektit.

GRUPET E SYNUARA DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Grupi i synuar	Objektivat specifike	Komente
Palët kryesore të interesit të projektit	Të informohen palët kryesore të interesit të projektit për objektivat dhe progresin e projektit	Ky grup përfshin Sekretariatit e DG NEAR/WBIF; Delegacionin e BE-së në Shqipëri; CEB-in; Kryeministrinë; Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës; Ministrinë e Arsimit dhe Sportit; Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët; Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; 61 bashki në 12 qarqet shqiptare (d.m.th. të gjitha bashkitë shqiptare); Drejtoritë rajonale të arsimit/shkollave
Përfituesit përfundimtarë (nxënësit parauniversitar në shkollat përkatëse) dhe publiku i gjerë në Shqipëri, duke përfshirë shtypin	Të përmirësohet ndërgjegjësimi i përfituesve përfundimtarë për infrastrukturën e TIK-ut të vënë në dispozicion Të sigurohet vizibilitet i lartë dhe përmirësim i ndërgjegjësimit të përgjithshëm për mbështetjen e BE/WBIF për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Shqipëri	Shumica e burimeve të disponueshme për aktivitetet e komunikimit dhe dukshmërisë në kuadër të këtij granti do t'i dedikohen arritjes së këtij objekti.
Publiku i gjerë në rajon dhe në shtetet anëtare të BE-së	Të sigurohet vizibilitet i lartë dhe përmirësim i ndërgjegjësimit të përgjithshëm për mbështetjen e BE/WBIF për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Shqipëri	Ky objektivi do të arrihet kryesisht nëpërmjet kanaleve të komunikimit WBIF, EUD dhe CEB

AKTIVITETET E KOMUNIKIMIT

Minimalisht, aktivitetet e komunikimit dhe vizibilitetit do të përfshijnë:

(1) Përgatitjen e fletëve përmbledhëse të projektit në gjuhën angleze dhe lokale; përgatitjen dhe prodhimin e posterit të projektit (pas përfundimit të projektit). Materialet do të shqyrtohen nga CEBi, EUD-i dhe WBIF-i.

(2) Përgatitjen dhe prodhimin e tabelave dhe pllakave për të gjitha shkollat e përfshira në projekt, gjatë dhe pas përfundimit të punimeve. Tabelat dhe pllakat do të shqyrtohen nga CEB-i, EUD-i dhe WBIF-i.

(3) Organizimin e një eventit (fillimi/mbarimi i projektit), minimalisht, me pjesëmarrjen e palëve të interesit të BE-së dhe WBIF-it dhe shtypit, duke përfshirë paketat e shtypit. Në mënyrë të veçantë, përfituesi dhe kontraktori i tij i komunikimit do të punojnë në arritjen e marrëveshjeve të mëposhtme nga të gjithë grupet kryesore të interesit: ora e eventit, axhenda, pjesëmarrësit dhe njoftimi për shtyp dhe paketa për shtyp.

(4) Përgatitjen e një videoje të shkurtër të projektit, ose: a) një video e animuar që prezanton projektin me publikun e gjerë dhe palët kryesore të interesit, që do të prodhohet në fillim të punimeve; ose b) një video që identifikon përfitimet e Projektit, pas përfundimit. Lloji i videos që do të prodhohet do të koordinohet me Sekretariatit e CEB-it dhe WBIF-it; pasi të jetë rënë dakord, videoja do të përgatitet dhe prodhohet në koordinim të ngushtë me CEB-in, EUD-in dhe WBIF-in.

(5) Prodhimin e materialeve promovuese/informative/grafike, sipas rastit, për përdorim në fushatat informative të BE/WBIF, si dhe nga CEB-i dhe grupe të tjera kryesore të interesit të projektit (p.sh. Ministria për Investimet Publike. Materialet do të shqyrtohen nga CEB-i, EUD-i dhe WBIF-i para prodhimit.

Në fillim të projektit dhe si pjesë e progress raportit vjetor, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit do të paraqesë një plan të aktiviteteve konkrete që do të ndërmerren gjatë vitit, duke përfshirë datat (të parashikuara).

MJETET E KOMUNIKIMIT TË ZGJEDHUR

Janë përzgjedhur mjetet e mëposhtme të komunikimit, të diferencuara midis grupeve të synuara. Në fillim është supozuar se, për qëllime të qëndrueshmërisë, projekti nuk do të ketë një faqe interneti të dedikuar ose llogari të mediave sociale. Në vend të kësaj, kanalet që kanë ekzistuar paraprakisht do të përdoren nga palët kryesore të interesit (Delegacioni i BE-së, PIU/ Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Arsimit, CEB, WBIF) për të promovuar rezultatet e përshkruara më poshtë, sipas rastit.

Grupi i synuar	Mjetet/aktivitetet e komunikimit
Palët kryesore të interesit të projektit	• fletë përmbledhëse e projektit në gjuhën angleze dhe lokale; • poster i projektit • tabela dhe pllaka • ngjarjet • video(at) • materiale të tjera grafike/narrative
Përfituesit përfundimtarë (nxënësit parauniversitarë në shkollat përkatëse) dhe publiku i gjerë në Shqipëri, duke përfshirë shtypin	• fletë përmbledhëse e projektit në gjuhën angleze dhe lokale; • poster i projektit • tabela dhe pllaka • video(t) • ngjarjet • materiale të tjera grafike/narrative për përdorim gjatë fushatave informative BE/WBIF dhe në faqet e internetit të palëve kryesore të interesit dhe llogaritë e mediave sociale, sipas rastit.
Publiku i gjerë në rajon dhe në shtetet anëtare të BE-së	• fletë përmbledhëse e projektit në gjuhën angleze dhe lokale; • video(at) • materiale të tjera grafike/narrative për përdorim gjatë fushatave

	informative të BE-së dhe në faqet e internetit të palëve kryesore të interesit dhe llogaritë e mediave sociale, sipas rastit.
--	---

PLOTËSIMI I OBJEKTIVAVE TË KOMUNIKIMIT

Raportimi do të fokusohet minimalisht në:

- Numrin e materialeve narrative dhe grafike, duke përfshirë videot, të prodhuara gjatë periudhës së projektit
- Numrin e eventeve të organizuara me pjesëmarrjen dhe vizibilitetin e duhur nga BE-ja dhe/ose CEB-i
- Numrin e artikujve/përmendjeve (citimeve) në shtyp.

DISPOZITA PËR KOMENTE (KUR ËSHTË E ZBATUESHME)

Pyetësor online për palët kryesore të interesit, një vit pas zbatimit të projektit.

BURIMET NJERËZORE

Subjektet përgjegjëse për planifikimin dhe zbatimin e C&V janë: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe kontraktorët e saj – specialistët e komunikimit si dhe kontraktorët e punimeve dhe furnizimeve (në rastin e pllakave dhe tabelave në kantierin e ndërtimit).

BURIMET FINANCIARE

Një shumë totale prej 100,000 Euro do të alokohet nga fondi i siguruar nga Granti. Granti do të përdoret për të mbuluar koston e aktiviteteve të përfshira më sipër, me përjashtim të:

- Kostove të stafit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe çdo përfituesi tjetër
- Kostove të punimeve dhe furnizimeve kontraktorëve, në rastin e pllakave dhe tabelave në kantierin e ndërtimit (pasi këto përfshihen në koston e punimeve dhe furnizimeve).

SHTOJCA E
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me grantet nga CEB-i

NENI 1.1

Arbitrazhi

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve të Marrëveshjes së Grantit në lidhje me interpretimin ose ekzekutimin e një marrëveshjeje të tillë ose në lidhje me një pretendim nga njëra prej palëve në fjalë ndaj një tjetre që rrjedh nga marrëveshja e grantit, e cila nuk është zgjidhur me marrëveshje midis Palëve, do të paraqitet për arbitrazh në mënyrën e specifikuar më poshtë.

NENI 1.2

Fillimi i procedurës së arbitrazhit

Procedurat e arbitrazhit mund të fillojnë nga secila prej Palëve të specifikuara në seksionin e mësipërm me anë të një kërkesë të njoftuar për të gjitha Palët e tjera; kërkesa duhet të specifikojë natyrën dhe objektin e mosmarrëveshjes dhe të parashtrojë kërkesat që do të paraqiten për arbitrazh.

NENI 1.3

Caktimi i gjykatës së arbitrazhit

Në çdo procedurë arbitrazhi të filluar në zbatim të këtij Neni, secili Përfituesi dhe CEB-i mund të jenë palë.

Për çdo mosmarrëveshje të paraqitur për arbitrazh në bazë të këtij Neni, do të krijohet një gjykatë arbitrazhi. Ajo do të përbëhet nga tre arbitra të caktuar si më poshtë:

- (a) një arbitër do të caktohet nga CEB-i;
- (b) një arbitër i dytë do të caktohet nga Përfituesi;
- (c) një arbitër i tretë, i referuar si arbitri, i cili do të veprojë si Kryetar i tribunalit të arbitrazhit, do të caktohet me pëlqimin e përbashkët të palëve ose në mungesë të një pëlqimi të tillë, nga Kryetari i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ose, nëse këto të fundit kanë shtetësinë e Përfituesit, nga Zëvendëskryetari i Gjykatës, ose nëse ky i fundit ndodhet në të njëjtën situatë, nga më gjyqtari më i vjetër në detyrë që nuk ka shtetësinë e Përfituesit;

- (d) procedura e specifikuar në paragrafin e mësipërm do të zhvillohet, si kërkesë e njëres prej Palëve në mosmarrëveshje, nëse, brenda një muaji pasi është dhënë njoftimi për kërkesën për arbitrazh, nuk është arritur asnjë marrëveshje në lidhje me caktimin e një arbitri;
- (e) kur njëra nga palët nuk cakton asnjë arbitër, arbitri do të caktojë arbitrin në fjalë.

NENI 1.4

Vendi i arbitrazhit

Gjykata e arbitrazhit do të mbajë seancën e saj të parë në atë datë dhe në atë vend që do të caktohet nga arbitri. Pas kësaj, gjykata do të vendosë vetë se ku dhe kur do të mbledhet.

NENI 1.5

Ligji i zbatueshëm për procedurat e arbitrazhit

Gjykata e arbitrazhit vendos për të gjitha çështjet e lidhura me kompetencën e saj. Ajo do të përcaktojë rregullat e veta të procedurës dhe do të zgjedhë ligjin që do të jetë i zbatueshëm, përveç rasteve kur ai ligj specifikohet në kontrata ose në marrëveshjen e arbitrazhit, duke pasur parasysh dispozitat e Nenit 1 (3) të Protokollit të Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës. Të gjitha vendimet e gjykatës do të merren me shumicë votash.

E drejta e brendshme mund të zbatohet në një rast të veçantë me kusht që të mos shmanget nga Protokollit i Tretë i Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet e Këshillit të Evropës dhe nga Nenet e Marrëveshjes së CEB-it.

NENI 1.6

Vendimi i tribunalit të arbitrazhit

Të gjitha vendimet e tribunalit të arbitrazhit do të përcaktojnë arsyet për vendimin. Ato do të jenë përfundimtare dhe detyruese për të gjitha palët e përmendura në Nenin 1.3. Ato mund të jepen në mungesë të parashtrimeve.

NENI 1.7

Kostoja e arbitrazhit

Pala ndaj të cilës është marrë vendimi, do të përballojë shpenzimet e procedurës së arbitrazhit, përveç nëse tribunali i arbitrazhit vendos ndryshe ose Palët kanë rënë dakord ndryshe me një klauzolë në Marrëveshjen e Grantit. Gjykata e arbitrazhit do të japë një vendim përfundimtar për çdo mosmarrëveshje në lidhje me shpenzimet.

NENI 1.8

Ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit

Marrëveshja e Grantit do të përmbajë çfarëdo dispozite që kërkohet për të siguruar, në lidhje me CEB-në dhe në lidhje me Përfituesin, pajtueshmërinë me çdo dhënie kontrate të bërë në bazë të kësaj Shtojce.

Nëse, brenda një muaji pasi origjinalet e vendimit u janë dorëzuar palëve, vendimi nuk është respektuar, secila nga palët e specifikuar në Nenin 1.3 mund të fillojë procedura për zbatimin e vendimit. Gjykata e cila do të ketë juridiksion për këto procedura do të jetë ajo e caktuar nga rregullat e procedurës civile të Shtetit në fjalë.

